



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 13.11.2014, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i projektbuxhetit të vitit 2015 për institucionet:

Ministrinë e Brendshme (*Gjendjen Civile, Prefekturat*)

Pushtetin Vendor

Prokurorinë e Përgjithshme

Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

Këshillin e Lartë të Drejtësisë

Gjykatën Kushtetuese

Shkollën e Magjistraturës

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Nard Ndoka, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Tahir Muhedini, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka dhe Mark Frroku.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Piro Lutaj, Kastriot Islami, Gjovalin Bzheta, Armando Prenga, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Eduard Halimi, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Arben Ristani, Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Saimir Tahiri – Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Edlira Sallaku – Këshilltare në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Viktor Hysaj – Drejtor i Financave në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Shkëlqim Cani – Ministër i Financave

Mimoza Dhëmbi – Drejtore e buxhetit në Ministrinë e Financave

Fran Ibrahim – Ministria e Financave

Geraldina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave.

Genti Kosumi - Sekretar i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme

Luan Abazi - Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sandër Simoni - Anëtar i Bordit Drejtues Zyrës Administrimit Buxhetit Gjyqësor (kryetar i Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda)

Luljeta Laze - Drejtore e Zyrës Administrimit Buxhetit Gjyqësor .

Laerta Poda - Drejtoria e buxhetit dhe investimeve të ZABGJ.

Kujtim Osmani – Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese

Miran Kopani – këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë

Ela Qoku – Kancelare e Shkollës së Magjistraturës

Natasha Cita – Shefe e Financës

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen.

Së pari, dua t'u kërkoj ndjesë përfaqësuesve të qeverisë për vonesën, por në mënyrë të veçantë përfaqësuesve të medias dhe të gjithë atyre, që dëshirojnë të ndjekin këtë mbledhje komisioni, por për shkak të mungesave të deputetëve, nuk u arrit të bëhej i mundur kuorumi i nevojshëm i kërkuar nga Rregullorja për të filluar mbledhjen e komisionit.

Aktualisht, është mundësuar që të jetë kuorumi, kështu që sipas Rregullores mund të vazhdojmë normalisht mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës, siç është e njohur, është diskutimi i projektbuxhetit të vitit 2015. Sot do të dëgjojmë dhe shqyrtojmë projektbuxhetin fillimisht me Ministrinë e Brendshme, për atë pjesë që i takon këtij komisioni, për atë që mbulon ky komision në fushën e përgjegjësisë së tij. Deputetët janë të lirë të bëjnë pyetje, por fillimisht do të dëgjojmë ministrin që është i pranishëm.

Ju falënderoj, zoti Ministër që jeni i pranishëm! Do të dëshirojmë të dëgjojmë një përmbledhje të shkurtër rreth pjesës që mbulon buxheti për ato fusha që kanë të bëjnë me këtë komision.

Gjithashtu, i pranishëm është edhe ministri i Financave, zoti Cani së bashku me stafin e tij që do të diskutojmë rreth buxhetit të pushtetit vendor.

Zoti Tahiri, urdhëroni!

Saimir Tahiri – Faleminderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qeveria ka paraqitur pranë Kuvendit për miratim buxhetin e viti 2015, që respektivisht për Ministrinë e Punëve të Brendshme ka një rritje prej 14,7% në raport me planin fillestar të buxhetit të vitit 2014, që reflekton përparësitë që i jep Ministria e Punëve të Brendshme dhe qeveria kundër luftës së krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe mirëfunksionimit të

strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Gjendjes Civile, Shërbimi të Emergjencës Civile, si dhe strukturave të tjera në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për sa i intereson objektit të punës së këtij komisioni unë po fokusohem në 4 zëra kryesore: Gjendja Civile, ku ka një rrije të buxhetit të parashikuar për vitin 2015, prej 29,6%, i cili është specifikuar sipas zërave kryesorë të shpenzimeve në shpenzime të personelit 40%, shpenzime të tjera 55%, më shumë shpenzime për investime 5%.

Me këtë buxhet parashikuar për vitin 2015 arrijmë të mbajmë në mënyrë eficiente dhe efektive përditësimin e regjistrit të gjendjes civile, mirëfunksionimin e sigurt të infrastrukturës aktuale të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, si dhe përditësimin e kësaj infrastrukture në lidhje me të ardhmen e këtij regjistri dhe regjistrin kombëtar të adresave, ngritjen e *back up-it* të gjendjes civile, bëhet fjalë për mekanizmin e sigurisë, që garanton të dhënat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile nga çdo lloj fatkeqësie potenciale, vijimin e punës për plotësimin e informacionit të nevojshëm për adresarin 31 njësi, si dhe shfrytëzimin dhe garantimin e sistemit eficient dhe të sigurt për autorizimin dhe certifikimin e aplikimeve, për lëshimin e dokumenteve të identitetit, letërnjoftime dhe pasaporta.

Dua të theksoj pranë këtij komisioni se objektivi ynë themelor është mbështetja financiare për shkrirjen e Regjistrit të Gjendjes Civile dhe regjistrin të adresave. Ky është një objektiv madhor që i jep fund një herë e mirë kaosit me shtetasit, të cilët kanë më shumë se një rezidencë të deklaruar, pra, një vendbanim permanent të deklaruar; i jep fund një herë e mirë kaosit me listat e zgjedhësve; i jep fund një herë e mirë paqartësisë në të dhënat parësore për sistemin fiskal apo për çdo të dhënë tjetër që mund t'i duhet çdo lloj institucioni. Pra, në qoftë se sot Regjistri i Gjendjes Civile dhe regjistri i adresave janë dy gjëra të ndryshme vështirësisht të komunikueshme, shkrirja e këtyre dy regjistrave në një të vetëm do të na lejojë përfundimisht të bëjmë përputhjen definitive ndërmjet njerëzve dhe pasurive në këtë vend.

Ky është një objektiv madhor që kërkon financim, i cili nuk përballohet nga buxheti i vitit 2015, megjithatë garantojmë një nisje të mirë. Gjithsesi, paralelisht jemi duke punuar me partnerët për të financuar dhe buxhetuar këtë projekt, duke qenë se një projekt i tillë kërkon edhe ekspertizë të theksuar për të cilën ne sot nuk e kemi.

Në buxhetin e gjendjes civile është parashikuar edhe një shumë për sa i takon shpërblimeve të lindjes. Theksoj këtu që kemi trashëguar një borxh prej 600 milionë lekësh nga qeveria e kaluar. Këtë shumë të trashëguar si borxh e kemi kaluar në kuadër të detyrimeve, të cilat priten të shlyhen nga qeveria dhe presim nga Ministria e Financave për t'u financuar brenda këtij viti.

Për sa u takon prefekturave dhe funksioneve të deleguara në buxhetin e vitit 2015 është parashikuar ajo shumë buxheti që është kërkuar edhe nga vetë prefekturat.

Për sa u takon emergjencave civile në vitin 2014 është bërë financimi i 23 projekteve, që kanë të bëjnë kryesisht me ndërhyrje parandaluese dhe rehabilituese në infrastrukturë publike si ura, mure mbajtëse etj. Sigurisht kjo është shumë larg nga kërkesat e njësisve të pushtetit vendor është shumë larg edhe nga kërkesat tona, por me buxhetin e vitit 2014 kjo ishte mundësia jonë për t'i dalë përpara fatkeqësive potenciale.

Në vitin 2015 totali i shpenzimeve është 799 mijë lekë, i shpenzuar sipas zërave kryesorë “personel dhe shpenzime të tjera”, ndarë respektivisht 74% dhe 26%. Në lidhje me tavanet shpenzimet për emergjencën civile buxheti i planifikuar është 110 milionë lekë për situatat emergjente.

Kemi detyrime të prapambetura në këtë zë, për situatat e krijuara nga fatkeqësitë natyrore në të kaluarën dhe borxhi i trashëguar është mbi 1,8 miliardë lekë, të cilin ne nuk mundemi ta financojmë dhe ky është po kështu një detyrim që është përfshirë në kërkesat tona për Ministrinë e Financave dhe që shpresojmë të kemi një përgjigje definitive për financimin e tij brenda këtij viti.

Për sa u takon rezervave të shtetit buxheti ka një rritje prej 11% në raport me buxhetin e vitit 2014, duke shpresuar që gjendjen skandaloze që gjetëm në rezervat e shtetit ta përmirësojmë disi jo vetëm me input buxhetor, por edhe me rrugë alternative së bashku me sipërmarrësit për të qenë në gjendje të garantojmë minimumin e rezervave në raste fatkeqësish.

Ky është prezantimi paraprak dhe jam i hapur për çdo pyetje nga deputetët.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Kush nga kolegët ka pyetje?

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se jeni me fat që jeni një ndër institucionet që keni marrë një rritje të buxhetit në zëra që janë jetike për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe sigurinë në vend.

Unë kam një pyetje në lidhje me pjesën e buxhetit që i është akorduar pjesës së Policisë së Shtetit, për mekanizmat e parandalimit të krimit, në kuadër edhe të riorganizimit që do të ketë qeverisja vendore.

Sa dhe si do të përmbushen nevojat për mbështetjen e viktimave të trafikimit për sistemin e mbajtjes së të dhënave të sakta, kërkesa të BE-së, njëkohësisht edhe për parandalimin e kriminalitetit në zonat qoftë rurale dhe urbane, jo vetëm me rritje të numrit të punonjësve të policisë, por edhe për ngritjen e mekanizmave që do të mundësonin një gjë të tillë?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër, urdhëroni!

Saimir Tahiri – Faleminderit, për pyetjen!

Shqetësimi është i drejtë për sa i takon edhe njësisë antitrafik, edhe mekanizmave parandaluese për kriminalitetin në vend. Pavarësisht se unë mendoj që mekanizmat parandalues nuk janë ekskluzivitet i policisë, por shkojnë shumë më shumë përtej si vazhdim i sistemit të mekanizmave që japin drejtësi deri te gjykatat, dhe po ashtu si ngritje e mekanizmave permanent, shoqëror apo institucional që ka ndikim në parandalimin e fenomeneve kriminale në vend.

Buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe zëri i Policisë së Shtetit nuk është i ndarë sipas çështjeve për të cilat është i detyruar të impenjohet policia.

Viti i kaluar ishte hera e parë që njësia antitrafik buxhetohej dhe kjo vazhdon edhe këtë vit, duke i kushtuar rëndësi themelore përpjekjeve tona për ta nxjerrë Shqipërinë nga lista e vendeve problematike në raport me trafikimin e qenieve njerëzore.

Në raport me buxhetin e vitit 2014, falë edhe impenjimit të strukturës përkatëse dhe koordinаторit kombëtar kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ne arritëm ta nxjerrim Shqipërinë nga lista e vendeve në vëzhgim, të Departamentit Amerikan të Shtetit për trafikimin e qenieve njerëzore. Objektivi mbetet përparimi ynë në përmbushje të kushteve dhe kriterëve

institucionale, por së bashku me partnerët, edhe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, që nuk është një fenomen që ndalon brenda kufijve të Shqipërisë, për të qenë realistë.

Mekanizmat e parandalimit të kriminalitetit, për sa i takon Policisë së Shtetit, fillojnë që nga policimi në komunitet, i cili duke filluar nga janari do të jetë prioritet maksimal më vete, duke e konsideruar policimin në komunitet gur themeli për funksionimin e policisë jo vetëm nga pikëpamja e kontaktit me qytetarët, por edhe në raport me nivelin e informacionit që ndan qytetarin me Policinë e Shtetit.

Kemi nisur dhe besoj që mbarojmë brenda këtij viti zyrat e shërbimit unik për qytetarët, pavarësisht se në pamje të parë duket sikur nuk ka lidhje. Ndryshimi i perceptimit të qytetarëve për Policinë e Shtetit si mekanizëm represiv, dhe kjo është një gjë e trashëguar prej shumë vitesh në një mekanizëm me mentalitet dhe filozofi shërbimi ndaj qytetarëve, ndikon domosdoshmërisht në prirjen personale të gjithkujt dhe pastaj në prirjen kolektive të shoqërisë për ta konsideruar Policinë e Shtetit jo armikun e të gjithëve, por armikun e atyre që shkelin ligjin dhe mikun e shumicës dërrmuese të popullsisë.

Nuk jam në gjendje t'ju them sot nivelin e buxhetimit të këtij projekti, sepse ky është një projekt, të cilin e zhvillojmë me partnerët ndërkombëtarë dhe kjo i takon detajimit të buxhetit në Policinë e Shtetit, për të cilën unë jam shumë i angazhuar ta monitoroj nga afër në mënyrë që ky zë, pra policimi në komunitet, zyrat e shërbimit unik dhe mekanizmat e tjerë të ndikojnë në parandalimin e kriminalitetit. Krijimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet komunitetit dhe policisë të financohet në mënyrë, nuk mund të them të plotë, por të kënaqshme për të përmbushur objektivin.

(Diskutime pa mikrofon)

Cila është pyetja konkrete?

Vasilika Hysi – Një nga detyrimet që ka institucioni i Policisë së Shtetit është që të përpunojë statistikën, të cilat të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të krahasueshme, por mbi të gjitha të ndiqet efica e efektiviteti të luftës, sidomos në fushën e krimit të organizuar, të drogave dhe të korrupsionit. Një nga problemet që ka pasur vazhdimisht Policia e Shtetit, por edhe Ministria e Brendshme ka qenë që nuk ka një sistem, i cili të funksionojë dhe të japë mundësi të krahasosh efica e tyre. Ju e keni prioritet, por sa mbulohet në buxhet?

Sajmir Tahiri – Ndoshta meriton një debat më të gjatë, por unë nuk besoj që Policia e Shtetit dhe Ministria e Punëve të Brendshme, pastaj në raport Prokuroria dhe sistemi gjyqësor kanë pasur ndonjëherë problem çështjen e të dhënave lidhur me kriminalitetin dhe analizat statistikore mbi to. Por, gjithsesi, kërkon, dhe unë bie dakord, objektiv madhor është rakordimi i një sistemi zinxhir të të dhënave mbi kriminalitetin dhe, në qoftë se bëhet, kjo pastaj shërben edhe për raporte analitike, shërben edhe për analizim të situatës.

Keys Management është një sistem që po ngrihet me asistencë e ngushtë të partnerëve ndërkombëtarë. Jemi në fazën e trajnimit të punonjësve të policisë, duke pretenduar nga çdo punonjës policie që të ketë akses të drejtpërdrejtë vetë në sistem, lidhur me raportimin e ngjarjeve kriminale dhe monitorimin pastaj të fatit të tyre në vazhdimësi, ndërkohë që ne kemi futur edhe sistemin e numrit unik të çështjes, i cili është identifikativi i çdo kallëzimi prej qytetarëve, nga njëra anë për të eliminuar përfundimisht rastet kur qytetari paraqitet në një komisarjat ose në post policie dhe nuk i merrej kallëzimi me pretendimin që ishte ngjarje irrilevante për policinë dhe raste të tilla kanë qenë plot.

Ne jemi në reformimin e këtij sistemi për ta konsideruar numrin unik, faturën që merr mbrapsht qytetari në momentin që paraqitet në polici, e para, dhe nga ana tjetër si identifikativin e çështjes së tij në raport me fatin e ecurisë së hetimeve apo procedimit penal lidhur me kallëzimin që bën vetë qytetari me këtë numër mund të interesohet, jo vetëm në çdo post policie dhe çdo komisarjat dhe drejtori, por në të gjitha institucionet, sepse numri unik i çështjes ka lidhje me Keys Management, pra me sistemin e menaxhimit të çështjes, ashtu siç ka lidhje edhe me ecurinë e çështjes deri në fazën finale të saj.

Gjithsesi, kjo mbetet prapë e padetajuar në buxhetin që ju keni para. Unë ju falënderoj për pyetjen dhe ne e kemi në konsideratë, sepse është një projekt vazhdues që nga viti i kaluar dhe është detyrues i buxhetueshëm.

Fatmir Xhafaj – Ju faleminderit!

Zoti Ndoka pyetje.

Nard Ndoka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër,

Kisha një pyetje për fondin e emergjencave civile, për faktin që është një zë shumë i rëndësishëm për buxhetin tuaj, por ju nuk i keni dhënë rëndësinë e duhur, duke pasur parasysh se

keni edhe shumë detyrime të prapambetura, ku mund të përmend rastin e përmbytjeve në qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës, ku janë disa familje që nuk kanë marrë dëmshpërblimet, por ka edhe raste të ndryshme, ku mjaft familjeve u janë shembur shtëpitë dhe sot janë të pastrehë dhe presin buxhetimin nga Ministria e Brendshme.

Meqenëse është prezent edhe Ministri i Financave, ka pasur një vendim të Këshillit të Ministrave kohë më parë që këto detyrime të ishin nëpërmjet KESH-it dhe Ministrisë së Brendshme, nuk e di se cila është vendimmarrja juaj politike që këto detyrime do të jenë nga buxheti i Ministrisë së Brendshme apo vazhdon të jetë në fuqi një vendim i tillë.

Do të kërkoja që Fondi për Emergjencat Civile të përfshinte komplet detyrimet që ka shteti shqiptar ndaj atyre familjeve, të cilat janë të dëmtuara ndër vite nga përmbytjet për ta shlyer atë pjesë të detyrimeve që ne kemi. Nuk besoj se është në të drejtën tuaj as ligjore, as morale dhe as politike që të filloni të vendosni një shenjë ose një vizë, duke mos e marrë në konsideratë të gjithë atë problematikë që atyre familjeve u është shkaktuar nga natyra apo nga pakujdesia e institucioneve.

Zoti Ministër,

Pyetja e dytë është që kohët e fundit kemi vërejtur që Policia e Shtetit futet gjithandej në çdo aksion që ndërmerr qeveria. A keni menduar për ta ndryshuar këtë strategji, për faktin që, në njëfarë mënyre, po keqpërdoret policia edhe jashtë funksionit...

Fatmir Xhafaj – Zoti Ndoka, ju lutem, Ministri është vetëm për buxhetin këtu.

Nard Ndoka – Do ia parashtroj, sepse për buxhetin e kam edhe unë pyetjen, ta mbaroj sepse kisha një parashtrim për të dalë te projektbuxheti.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Për një pjesë të kufizuar që të jemi korrektë.

Nard Ndoka – Është shumë e rëndësishme që duke i forcuar këto institucione, pra të mos jetë e domosdoshme që bashkë me elektrikistin të shkoj edhe një polic, sepse kur funksionon shteti dhe ligji nuk është e nevojshme që bashkë me inspektorin e tatim-taksave të shkojë patjetër edhe një grup policie, të cilat janë fonde dhe kuptohet që shpenzohen, sepse e gjithë kjo lëvizje e policisë, kërkon një mbështetje financiare dhe do të ishte shumë e rëndësishme që këto fonde që shpenzohen edhe me këto aksione mediatike më tepër të marrin fund që ne t'i rikthehemi zbatimit të ligjit normal, duke e parë Policinë e Shtetit si një institucion të rëndësishëm në

mbrojtje të qytetarëve dhe jo si një xhandarmëri, e cila shkon pas çdo njeriu që kërkon taksa, gjoba, burgje për çdo gjë të kësaj natyre.

Pra, a ka një strategji ministria juaj, kuptohet që ju mirëkuptoj me fazën e parë të këtij aksioni, por të paktën për vitet e ardhshme që me të vërtetë të jetë një polici funksionale?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër mund të përgjigjeni vetëm për atë pjesë, do t'ju lutesha, për atë pjesë për të cilën jeni thirrur në komision dhe që ka të bëjë me buxhetin dhe për atë pjesë të buxhetit që lidhet me këtë komision.

Deputetët janë të lirë të bëjnë pyetje në seancë plenare dhe ku dëshirojnë.

Po, zoti Ministër!

Sajmir Tahiri – Faleminderit!

Në fakt keni shumë të drejtë në pjesën e parë parashtruese të pyetjes që lidhet me detyrimet që trashëgon shteti shqiptar për qytetarët që fatkeqësi të ndryshme i kanë shkaktuar dëme dhe të cilat qeveritë ia kanë marrë përsipër. Unë bie dakord që nuk duhet bërë politikë, pavarësisht se politikë është bërë pafund lidhur me këtë çështje. Kjo qeveri ka shënuar një standard tjetër për të mos bërë politikë me këtë çështje dhe e quaj edhe vlerësim që ju heshturazi e shprehët, faktin që e njihni veprimin tonë lidhur me detyrimin e trashëguar.

Ministria e Punëve të Brendshme e ka vlerësuar si detyrim dhe e kemi kaluar në pjesën e detyrimeve të mbartura me Ministrinë e Financave. Ministri i Financave është këtu dhe mund ta konfirmojë, ky mbetet një detyrim i trashëguar për të cilin njëlloj si edhe për zërat e tjerë presim përgjigje definitive për shlyerjen e tij.

Nuk i kemi hyrë asnjë lloj rivlerësimi për detyrimet e kaluara, flas nominalisht për atë që kemi gjetur, por e kemi konsideruar detyrim dhe si të tillë e kemi kaluar menjëherë në Ministrinë e Financave, kjo është ajo që mund të bënte kjo qeveri dhe këtu nuk ka asnjë lloj gjesti politik.

Për sa i takon pyetjes së dytë, Policia e Shtetit është në krye të detyrës si një e tërë ndaj cilësdo lloj paligjshmërie. Unë nuk jam në gjendje dhe nuk besoj nëse ka punonjës policie në gjendje të bëjë dallim ndërmjet paligjshmërive në të vogla dhe në të mëdha, në të rëndësishme dhe në të parëndësishme. Unë di që Policia e Shtetit duhet të veprojë drejt ndaj të gjithëve.

Në qoftë se keni merakun se po stërmundohen dhe po lodhen punonjësit e policisë, ju faleminderit që interesoheni, por punonjësit e policisë po bëjnë detyrën. Në qoftë se keni merakun e buxhetit, buxheti reflekton prioritetet e qeverisë për të luftuar informalitetin dhe kriminalitetin në vend dhe Policia e Shtetit së bashku me institucionet e tjera është sigurisht e gjitha në këmbë për ta çuar përpara këtë që nuk është aksion, por që është qasje permanente dhe e tillë do të jetë, qasje permanente e të gjithëve ne, besoj dhe juaja, ndaj të gjithë atyre që shkelin ligjin.

Dhe në këtë kuadër, në qoftë se keni merakun se Policia e Shtetit po gjendet në vështirësi, do të mirëprisnim çdo propozim tuajin ose mbështetje tuajën në krah të Policisë së Shtetit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër.

Zoti Fino, për ta mbyllur si relator.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Duke falënderuar të dy ministrat që janë këtu, edhe unë kam disa pyetje në lidhje me pushtetin vendor. Ministri i Brendshëm mbulon prefekturat, gjendjen civile, menaxhimin e rezervave dhe emergjencat civile. Duke përfutur që është i pranishëm këtu edhe ministri i Financave, si relator do të doja të kuptoja, për të qenë i qartë kur t’ia dërgoj konkluzionet Komisionit të Ekonomisë, pse janë këto ndryshime. Pasi kam kontrolluar të gjitha tabelat, më rezulton, zoti Ministër, se për prefekturat ka 11 milionë lekë më pak se viti 2014.

Prefekturat kanë një numër stabil, bëjnë një punë të caktuar, të deleguar dhe nuk mendoj që në programin e saj të ketë më pak fonde se në vitin 2014.

E dyta, kërkesa shtesë në këtë program për investime në prefekturë ka qenë për 70 milionë lekë. Sa është marrë në konsideratë nga Ministria e Financave kjo, kur të gjithë e dimë se një pjesë e mirë e godinave në prefektura janë në gjendje shumë të mjerueshme dhe kërkojnë ndërhyrjen.

Më vjen çudi, por mbase përgjigjen për këtë pyetje nuk mund të ma ktheni ju, por ministri për Çështjet Vendore, në program ju emërtoni në buxhet “funksione të deleguara të prefekturës”, ndërkohë që funksioni kryesor i deleguar është gjendja civile, për mendimin tim. Ky emërtim “prefekturat dhe funksionet e deleguara” më duket se nuk qëndron.

Për gjendjen civile ka një shtesë, siç thatë edhe ju, 30%, por më vjen çudi dhe dua të pyes çfarë performance ndryshe do të ketë në vitin 2015 në raport me vitin 2014 në gjendjen civile që të merret një shtesë kaq e madhe?

E dyta, për gjendjen civile ju keni kërkuar 1 miliard e 17 milionë lekë investime si kërkesë shtesë. Sa nga këto janë të plotësuara nga Ministria e Financave të cilat ju doni t'i realizoni?

Flasim për menaxhimin e rezervave të shtetit. Në fakt, ju sot këtu duhet të na thoshit së bashku me ministrin e Financave se si ka qenë performanca e rezervave të shtetit në vitin 2014. Çfarë kemi realizuar me këtë? Si ka ecur ajo? Dhe mbi bazën e saj ne programojmë rezervën e shtetit për vitin 2015. Ne sot nuk dimë të themi se si është realizuar dhe si ka qenë performanca e vitit 2014, dhe nga kjo pamje ne nuk e dimë gjendjen. Ne mendojmë se do të vijë duke u rënduar dhe në këtë moment natyrisht që buxheti i shtetit duhet t'i përgjigjet nëpërmjet menaxhimit të rezervave të shtetit. Në këtë program keni shtuar 61 milionë lekë. Nuk e di se sa është plotësuar nga Ministria e Financave.

Shërbimi i emergjencave civile ka 61 milionë lekë më pak se viti 2014. A mund të na shpjegoni se pse kjo ulje prej afro 8%? Ky shërbim ka kërkuar në fakt 142 milionë lekë shtesë investime, nuk e di se sa do të jenë të plotësueshme dhe, siç e bëra pyetjen më lart për rezervat e shtetit, sa ky buxhet mund t'i përgjigjet riskut të dimrit të gjatë të ashpër që mund të ketë.

Ndonjëri këtu mund të mendojë se këto janë pyetje teknike dhe të vogla, por këto janë pyetje shumë të rëndësishme, pavarësisht se pjesa e luanit për buxhetin e Ministrisë së Brendshme është pjesa e policisë dhe unë nuk e preka pjesën e planifikimit, sepse është çështje e Komisionit të Sigurisë. Këto tri elemente janë të vogla, janë në varësi të Ministrisë së Brendshme, por janë shumë të rëndësishme për mendimin tim. Këto duhet të kenë kujdes të veçantë edhe nga Ministri i Brendshëm, por edhe nga qeveria dhe ministri i Financave se, në fund të fundit, përplasen shumë komunitete.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Saimir Tahiri- Faleminderit, zoti Fino!

Unë në fakt ndaj të njëjtin vlerësim me ju, sepse pavarësisht reflektimit buxhetor në Ministrinë e Brendshme, janë po aq të rëndësishëm edhe zërat tjerë dhe po aq me ndikim në jetën e përditshme të qytetarëve dhe, si të tillë, ne u kemi kushtuar vëmendjen maksimale.

Për sa i takon shqetësimit për prefekturat, ne u jemi përgjigjur kërkesave të vetë prefekturave, por ka një ulje, e cila vjen si pasojë e riorganizimit dhe konkretisht shkrirja e disa nënprefekturave, si e tillë është reflektuar edhe në buxhet. Unë tani nuk di të them konkretisht në përqindje, por është reflektuar edhe në buxhet, por ndërkohë kërkesat e prefekturave vetë janë pasqyruar tërësisht.

Funksionet e deleguara janë jo vetëm gjendja civile, por dhe shërbimi i zjarrfikësve, i cili përfshihet gjithashtu.

Është e vërtetë sa thoni për gjendjen civile. Ka një rritje. Ne i kemi kushtuar shumë vëmendje shkrirjes së dy regjistrave. Ne konsiderojmë objektiv madhor, në radhë të parë, ngritjen në funksionim të vërtetë të regjistrit të adresave, sepse e kemi trashëguar gjysmëfunksional, dhe në radhë të dytë, shkrirjen e atyre regjistrave në një të vetëm. Regjistri i gjendjes civile nga njëra anë regjistri i adresave nga ana tjetër, sipas nesh duhet të përbëjnë një regjister unik, ku të dihet se kush banon, ku, dhe prej nga ku, që të prodhohet në mënyrë definitive lista e zgjedhësve, pa pasur mundësi për kontestim dhe pa pasur banorë të paidentifikueshëm në adresë dhe, pastaj sigurisht me efektet përkatëse në sistemin që pason të institucionet e tjera që duhet të shfryjnë databasin e të dhënave të qytetarëve dhe vendbanimeve, përfshirë këtu në radhë të parë dhe mbi të gjitha *fiskun* dhe sistemin e pasurive të paluajtshme.

Ky për ne është një objektiv maksimal dhe unë besoj se ka një ndikim të madh dhe të paneglizhueshëm në jetën e përditshme të qytetarëve, por edhe në kapacitetin e institucioneve për t'i shërbyer qytetarëve. Si i tillë nuk është buxhetuar dot plotësisht, por nisim një rrugë që do të na marrë kohë, do të na marrë edhe kapacitete buxhetore të tjera, kërkon edhe ekspertizën ndërkombëtare dhe ndihmë financiare nga partnerët ndërkombëtarë dhe për këtë jemi duke punuar, por kjo i përgjigjet gjithsesi edhe ndarjes buxhetore të parashikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të miratuar nga qeveria në buxhetin e vitit 2015.

Për sa u takon rezervave të shtetit ka një rritje prej 11%. Ne besojmë se në raport me gjendjen që trashëguam kemi bërë hapa para për të garantuar atë minimum që unë e shpjegova dhe më sipër për sa i takon kapacitetit tonë për të përballuar emergjenca civile të rangut të rëndë, le të themi. Kuptohet që trashëgiminë e shkatërrimit dhe shpenzimit pa asnjë kujdes të rezervave të shtetit deri në pikën që e gjetëm thuajse të marrë fund, ne nuk e rikuperojmë dot në një vit as

në dy vjet, do të na duhet kohë. Por gjithsesi nga viti i kaluar, viti buxhetor që vjen, të paktën, shënon hapat e duhur të qeverisë për të kthyer gjendjen në normalitet.

Unë e kuptoj shqetësimin tuaj. Është shqetësimi ynë maksimal, por mundësitë këto janë. Edhe unë i pakënaqur jam, por këto janë mundësitë për të buxhetuar rezervat e shtetit. Nuk janë në nivelin që ne do të donim, por 20 vjet shkatërrim nuk mund t'i rikuperojmë dot në 2 vjet.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Bashkim Fino – Nëse financa ka ndonjë sugjerim, por unë mendoj edhe për shkak të eksperiencës që kanë ministrat qoftë çështje për që kanë të bëjnë me emergjencat civile, qoftë ato që kanë të bëjnë me rezervat e shtetit në momente të caktuara qeveria ka edhe instrumente të tjera për të prekur, siç është rezerva e shtetit dhe që këtu janë disa momente të planifikimit dhe kanë bërë mirë që i kanë planifikuar kaq. Natyrisht unë sugjeroja që të planifikonin më shumë, por duhet ta kenë parasysh se çdo gjë që mund të ndodhë nesër, do të jenë prapë këta dy ministra që do të t'i japin qeverisë mundësinë për të prekur nga rezerva e shtetit, për të zgjidhur ndonjë problem që mund të kenë me emergjencën. Programet e Ministrisë së Brendshme të jenë më të kujdesshme bashkë me ato të financave kur vjen puna për emergjencat civile, edhe për shqetësimin që kishte kolegu i opozitës, sepse janë çështje që kjo qeveri ka marrë përsipër t'i zgjidhë.

Kështu që, nëse zoti Ministër bie dakord, edhe si relator, unë nuk kam ndonjë vërejtje për pjesën për pushtetin vendor, ta quajmë të ezauruar dhe të vazhdojmë më tej.

Faleminderit!

Shkëlqim Cani – Unë mbështes zotin Fino. Vërtet, ajo që tha zoti Fino, në lidhje me çështjen e kontigjencës, është e mirënjohur. Të flasësh për emergjenca gjithnjë do të bëhen planifikime, por asnjëherë nuk mund të parashikosh ngjarje që do të vijnë, sepse ato janë të papritura. Kështu që për këtë arsye ne kemi bërë negociatat për të gjetur optimumin e parashikueshmërisë dhe për të dhënë fondet përkatëse, për shembull, meqenëse kemi disa evidenca, deri tani janë realizuar 70% e vitit 2014. Më jepet rasti për të thënë se ka kohë ende, por uroj që të mos përdoret se ne nuk do të dëshironim që të kishim ngjarje. Ka ende gjendje dhe për vitin 2015 është marrë parasysh një ecuri lidhur me këtë çështje, por gjithnjë duke i pasur në vëmendje që, në fund të fundit, kontigjenca që është ruajtur, është një shumë relativisht e madhe për këto ngjarje.

Viti 2015 ka shlyerje të prapambetjeve, pra ndërsa në vitet 2013, 2014 jo gjithçka shlyhej, në vitin 2015 shlyerjet e detyrimeve të prapambetura janë një zë më vete, që është jashtë këtij buxheti ose i përfshirë në shumën 20 miliardë lekë që janë shlyerjet e të gjitha pagesave të vonuara.

Përveç një veçorie që e përmendi edhe zoti Fino po edhe deputeti paraardhës lidhur me KESH-in, është në fakt një vendim që na e ka përzier kazanin dhe na ka vënë në vështirësi për arsye se kur kemi miratuar strategjinë së bashku të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura kemi lënë jashtë edhe institucionet publike ose ndërmarrjet publike, kemi lënë jashtë edhe pushtetin lokal. Pra, në atë strategji që tashmë është e miratuar dhe që ne po zbatojmë për 72 miliardë lekë ose 720 milionë dollarë nuk është përfshirë as pushteti lokal as shlyerja e institucioneve publike dhe në rasti konkret themi KESH-i para të tjerëve. Kjo sepse na ka vënë gjithnjë nuk po flasim vetëm për qeverinë, zoti Noka, por po flasim dhe në marrëdhënie me të tretët që na kanë dhënë kredinë ku ne jemi zotuar që do të shlyejmë vetëm detyrime të qeverisë. Pra, edhe futja e KESH-it është një problem parimor për to. Ne kemi negociuar me ta, jemi përpjekur, por ngelet çështje në parim që ata ende nuk e kemi gjetur zgjidhjen. Ata do të vijnë përsëri tani në nëntor në datën 17 dhe ne përsëri do ta negociojmë për ta gjetur këtë zgjidhje, se e kuptojmë që është një çështje që duhet marrë zgjidhje, por dhe ajo VKM që ka dalë dhe ka dalë ashtu siç ka dalë na vë në vështirësi, aq më tepër që KESH-i vetë është në probleme dhe në hallet e veta dhe ne kemi filluar ristrukturimin.

Lidhur me pyetjen që bëri zoti Fino për riparime ose shpenzimet për këto prefekturat janë disa zëra. Këtu janë disa prefektura aq sa ne kemi gjykuar se është e mundur që të përfshihej një buxhet ku ka për shembull pajisje zyrash për të gjithë prefekturat, por sidomos janë marrë nënprefekturat në Pukë, Malësi e Madhe, prefektura Vlorë, Gjirokastra, Tepelena dhe Lezha. Pra, janë rikonstruksione të këtyre prefekturave. Kuptohet e dimë që janë dhe të tjera që mund të kenë probleme, por hap pas hapi. Nuk është lënë në harresë, por është gjetur ajo që ne mund të përballonim me një buxhet të projektbuxhetit të vitit 2015.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

E mbyllim dhe këtë pikë.

Faleminderit, zoti ministër i Brendshëm! Ndërkohë ne do të vazhdojmë me ministrin e Financave lidhur me buxhetin e pushtetit vendor për qeverisjen vendore.

Zoti Ministër i Financave do të dëshironim një përmbledhje të shkurtër të parashikimeve që ka buxheti në këtë fushë dhe pastaj t'i lëmë fjalën kolegëve deputetë.

Shkëlqim Cani - Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Po i bie shkurt, meqenëse ne kishim dhe prezantimin me *power point* dhe në takimin e kaluar shpenzuam goxha kohë për pushtetin lokal. Kështu që po mundohem që të përmend vetëm disa pika kryesore në buxhetin e pushtetit vendor për vitin 2015.

Pika e parë që doja të theksoja është se shpenzimet për buxhetin e pushtetit vendor për vitin 2015 rriten me 24,5% në krahasim me buxhetin e vitit 2014. Në qoftë se do të duam të bëjmë një krahasim me rritjen e shpenzimeve për të gjithë buxhetin e ekonomisë shqiptare, është vetëm 4,1%. Pra, fiks i bie me 0,1, pra 6 herë më shumë nga rritja që ka rritja e gjithë buxhetit. Pra, pushteti lokal merr 6 herë më shumë nga çfarë merr i gjithë buxheti i Shqipërisë për nga tempa. Për nga pesha që zë në buxhet nga 2,1 të GDP-së në vitin 2011 bëhet 2,8% e PBB-së bruto në vitin 2015. Për shqetësimin e zotit Fino, që e paraqiti nëpërmjet parashtresës së tij, si një njohës i pushtetit lokal, dëshirës, natyrisht edhe synimeve të përbashkëta edhe si qeveri por edhe të zotit Fino, meqenëse është edhe baza, në fakt duhen thënë 3 shtylla por unë di vetëm 2. Një është ministri i Pushtetit lokal dhe zoti Fino me komisionin përkatës që realizuan atë reformë të suksesshme. Ne synimin e kemi që të shkojmë tek 4% dhe për të arritur edhe vendet e rajonit. Ndoshta synimi është për një periudhë afatmesme deri afatgjatë për t'i kaluar ato, për arsye se pushteti lokal është një nga pushtetet mjaft të rëndësishme.

Tjetër çështje e reformimit janë të ardhurat tatimore që realizon pushteti lokal. Ka reforma të realizuara, ka dhe reforma në realizim. Është marrë një taksë që tashmë e realizon, për shembull, është e përqendruar te organet e tatim-taksave në qendër në Tiranë te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimtaksave, por nuk i është marrë shuma. Pra, është marrë vetëm administrimi dhe kjo lirshmëri, që i është krijuar pushtetit lokal për t'u marrë edhe me taksat e tjera ka sjellë rezultate pozitive për arsye se është rritur edhe niveli i tatimtaksave të grumbulluara për llogari të pushtetit lokal, pavarësisht se kush i grumbullon. Dhe për vitin 2015 llogaritjet e të ardhurave

nga tatim-taksat që do të realizojë pushteti lokal, pra në favor të pushtetit lokal do të jenë 18,5% më të larta ose 2,5 miliardë lekë më shumë.

Ajo që u theksua dhe herën e kaluar, çfarë do t'i kalojë pushtetit lokal është renta minerare. Pra, teoria që njëri ligj, pra njëra dorë ia jep tjetri e mban, ne hoqëm dorë, ashtu siç ka qenë një presion i vazhdueshëm, unë do të thosha dhe i komisionit tuaj që kur bëmë buxhetin e vitit 2014. Ne natyrisht reflektuam dhe për pasojë se buxheti i vitit 2015 ka shtim të rentës minerare në favor të pushtetit lokal 5 herë më shumë në praktikë sesa mesatarja që është dhënë në vitet e shkuara. Për këtë janë sjellë dhe rregullimet përkatëse ligjore. Natyrshëm janë rritur paratë dhe për ato që tani janë qendrat e qyteteve, që janë konceptuar si qytete inteligjente, investimet në qendrat e tyre, përmirësimi i imazhit dhe i pamjes. E parë nga disa këndvështrime dhe pse nga fakti që ndërhyrjet në mënyrë të vazhdueshme nuk kanë qenë thelbësore, nuk kanë dhënë ndonjë pamje tjetër të qyteteve, përveç ndërtimeve, me ndërhyrjen e dorës së shtetit, pra shumë pak ishte bërë për këtë, u pa edhe gjatë vitit 2014, edhe gjatë vitit 2015, është bërë një ndërhyrje me Fondin e Zhvillimit Rural, i cili ka marrë shtesa në këtë buxhet, në mënyrë që të ndërhyhet dukshëm. Themi se eksperiencia e vitit 2014 është një eksperiencë e suksesshme lidhur me këtë çështje dhe do të vijojmë në këtë drejtim. Dhe këtu pra rriten fondet në mënyrë të ndjeshme.

Përmirësim tjetër që ka buxheti i vitit 2015 lidhur me buxhetin lokal është fakti që deri në vitin 2012 në qoftë se do ta sjellim në kujtesë në prezantim, në vitin 2012, 74% e totalit të buxhetit vendor, edhe pse ishte i ulët, shpenzoheshin për shpenzime administrative dhe vetëm 26% shkonte për investime. Në buxhet është bërë një përmbyasje e këtij raporti. Viti 2015 e ka 58% investime në buxhetin lokal dhe janë pjesa e mbetur, pra është për administrativin. 58% janë investime në 2015-n, se ky raporti 42 me 58 është sot. Për 2014-n, 42% janë investime, pra nga 24% kemi shkuar deri në 42%, ndërsa në vitin 2015 do të shkojë 58% e investimeve. Pra, përmbyset raporti dhe kalon në favor të investimeve.

Mendoj se në praktikë ky raport do të shkojë edhe më shumë. Natyrisht do të ketë ashtu siç parashtroi në fakt zoti Fino më përpara, pranojmë ato që viti 2015 është një vit krejtësisht i veçantë dhe reforma administrative shoqërohet njëkohësisht me zgjedhje. Kemi një pushtet në ikje dhe një pushtet në ardhje, e quajta pushtete, sepse ka riorganizime, pra nga 340, 384 kalojmë në 61 njësi. Ka një riformatim dhe natyrshëm ka edhe të papritura. Për këto të papritura

unë pranoj atë që zoti Fino mendon se diçka duhet përmirësuar dhe ne do të jemi në kontakte me zotin Fino dhe me ministrin e Pushtetit Lokal, në mënyrë që të gjejmë atë që është optimalja, që fjalitë të jenë thënë të tilla që edhe anekset i kemi për arsye se anekset janë që të miratohen në Kuvend e japin garancinë që do të bëhen ato reforma dhe ato para do të shkojnë në ato destinacione, por të lëmë hapësira edhe për vendime të Këshillit të Ministrave, në mënyrë që grupi i ngarkuar me zbatimin në praktikë të reformës për çdo ngjarje ose për çdo veçori ose edhe paparishikueshmëri të ndërhyjë dhe për këtë është dashur dhe që fondet të mbahen dhe pak me rezervë dhe ashtu siç them që është mendimi i përgjithshëm ne të punojmë jo më me një buxhet jo e jo 1 -vjeçar, sepse do të ndahet në gjysmë, por edhe me muaj, në mënyrë që qeveria të mos jetë vetëm e kënaqur që mjafton t'i kalojë buxhetin dhe t'ia kalojë pushtetit lokal, por këto para të shkojnë në destinacionin e duhur. Ne na duhet shërbimi. Kemi dhënë 24% ose 6 herë më shumë për pushtetin lokal se sa është dhënë për të gjithë buxhetin. Kjo nuk do të thotë se duhet të jemi të kënaqur vetëm me ndarjen e fondeve. Ne duhet të jemi të kënaqur kur të realizohen shërbimet që vijnë nga këto fonde. Kjo është arsyeja që ne si Ministri e Financave, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Pushtetit Lokal, por dhe me ministri të tjera, Ministrinë e Brendshme ne në vijim do të jemi në ndjekje dhe kuptohet do të riallokojmë fonde sipas rastit. Unë po ju përmend çështje të cilat ne i kemi në diskutim të vazhdueshëm si grup pune në Ministrinë e Financave, por dhe me të tjerët. Për shembull diku krijohet një njësi e re dhe do të kërkojë ambiente të reja. Diku tjetër lirohen ambiente dhe duhet të mendohet se ku do të shkojnë dhe për çfarë do të përdoren ambientet. Se sa e rëndësishme është t'i gjesh ambientet e duhura një njësi administrative, po aq e rëndësishme nga pikëpamja e buxhetit është të gjejmë përdorim dhe ambientet që lirohen në mënyrë që të mos humbasim dhe ato para që mund të futen në eficiencë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për shpjegimin që dhatë, zoti Ministër, i cili ishte në vijim të një ekspozite të gjatë dhe të qartë që bëtë në seancën e mëparshme kur bëtë paraqitjen e buxhetit. besoj se tani është momenti që të dëgjojmë dhe pyetjet e kolegëve për të dhënë përgjigjet respektive.

Fjalën e ka zoti Klosi.

Blendi Klosi - Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, në fakt hyj tek ata qytetarë që i besoj shtetit dhe stafeve tuaja që kanë përgatitur buxhetet. Asnjëherë në eksperiencën time parlamentare nuk kam hyrë në detaje, sepse mendoj se po të hysh në detajet e buxhetit, në mungesë të informacionit, mund të bëjmë dhe gabime, por nuk mund të rri pa ju bërë një pyetje, e cila është shumë e pakuptimtë. Në tabelën nr.3, faqja 45 keni transfertat e pakushtëzuara për qarqet në vitin 2015.

Zoti Ministër, sipas cilës logjikë është bërë kjo ndarje e pakushtëzuar? Sipas cilës logjikë kjo ndarje e pakushtëzuar i çon qarkut të Durrësit, qarkut të dytë më të madh nga numri i popullsisë në vend, sasinë më të vogël të buxhetit? Sipas cilës logjikë kjo transfertë e pakushtëzuar i çon qarkut të Dibrës sasinë e dytë më të madhe në ndarjen e këtij buxheti në shkallë vendi?

Unë mendoj se kjo ndarje nuk mund të jetë logjike, për sa i përket numrit të popullsisë në Durrës ku banojnë mbi 400 mijë banorë. Ka një shtrirje shumë të madhe dhe ka me mijëra qytetarë të Dibrës që jetojnë sot në Durrës dhe marrin shërbime nga ky qark. Nuk mund të jetë praktikë, sepse historia ka ndryshuar shumë edhe në menaxhimin e këtyre fondeve dhe kapacitetet janë të ndryshme në qarqe të ndryshme të vendit dhe nuk mund të jetë bashkëkohore.

Do të ndalem te stafi juaj, pasi formulat e vjetra të mbetura në sirtarët e ministrisë, nuk mund të jenë koherente në ndarjen e re të buxhetit për institucione të caktuara të vendit.

Zoti Ministër, çfarë logjike mund të ketë kjo ndarje për qarkun e Durrësit, i dyti më i madhi në vend? Nuk po e them pse jam deputet i atij qarku, do ta bëja për çdo qark tjetër, por e shikoj pa asnjë logjikë praktike këtë ndarje të buxhetit të pakushtëzuar.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Klosi!

Po, zoti Ministër!

Shkëlqim Cani - Lidhur me transfertën e pakushtëzuar, unë jam në njohje të vazhdueshme, sepse është një kërkesë dhe pakënaqësi e njohur e pothuajse të gjithë deputetëve lidhur me atë që një rreth merr më shumë ose më pak se sa gjykohet, sesa mendohet. Unë nuk do të jap vlerësimet. Me të drejtë apo me të padrejtë, po vlerësohet nga deputetët që mund të jetë më shumë. Duke bërë krahasimin, siç morët ju dy rrethe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duke marrë dy qarqe që i përmendët ju. Kështu do të impresionohem edhe unë. Durrësi është një qark shumë më i madh në numër popullsie dhe më i dendur si qarku i Dibrës. Për rastësi jemi deputetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk e mora personale.

Kjo nuk është formulë që merr vetëm popullsinë, por merr parasysh edhe nivelin e mbledhjes së të ardhurave, numrin e rrugëve në gjatësinë që ka që nuk i ka në rrugë nacionale, por i ka lokale. Kuptohet që sa më malor të jetë një rreth, aq më shumë para do t'i duhen për të shpëtuar nga dëbora, për ta hapur, për ta mirëmbajtur. Po kështu kanë të bëjnë edhe faktorë të tjerë. Më mbetet merak edhe mua çështja e formulës.

E para, është një formulë që dendur i është kaluar PD-së. Në fakt kjo formulë është e USAID-it e vitit 2001 dhe ka hyrë në fuqi kur ka qenë në pushtet PS-ja dhe ajo nuk është ndryshuar. Janë bërë përshtatje me numrin e popullsisë e kështu me radhë. Kjo formulë është një formulë, që më thuhet, nuk e kam verifikuar, sepse nuk mund të marr përsipër se jam ministër dhe i di të gjitha, se funksionon në Gjermani dhe në Austri. Pra, nuk është një formulë që e dha dikush. Mund t'ju premtoj se edhe kur të shikohet ajo, do të jetë faktori ndërkombëtar, jo me atë që jemi mësuar, që të vijë një ndërkombëtar dhe të na bëjë formulën, por të vijë një i paanshëm dhe ne përsëri me një formulë do të dalim, sepse nuk mund dhe nuk duhet t'ia lëmë ministrit të Financave, po të doni edhe Kryeministrit, ministrit të Pushtetit Lokal që të bëjnë ndarjet. Ndarjet duhet të bëhen mbi bazën e disa koeficienteve. A janë këto që janë në këtë formulë, do të jenë edhe të tjerë, apo do të jenë krejt të tjerë? Këtë ia kemi lënë kohës. Jemi në bisedime me faktorin ndërkombëtar për të na sjellë një formulë të re. Përse nuk e bëmë për vitin 2015? Mund ta bënim, por ju thashë se viti 2015 është një vit, i cili bën një reformë totale të pushtetit lokal. Ne donim të merrnim të gjitha efektet, ato që i kemi hamendësuar dhe studiuar dhe kujtojmë se i dimë, por mjaft të papritura do të na dalin dhe do të ballafaqohemi. Është e natyrshme kur nga 380 do të kalosh te 61, do të dalin fenomene të reja, lëvizje të reja e kështu me radhë. Kjo do të na çojë në atë që të kemi një formulë më të qetë, më të qartë dhe për zona relativisht të stabilizuara ku janë hequr efektet e faktorëve të tjerë, që do t'i quaja të panjohura. Pra, do të ishim drejt të njohurës. Kjo është arsyeja që në njëfarë kuptimi nuk arritëm ta bëjmë këtë formulë të re që premtohet.

Duke qenë krejt të qartë për këtë gjendje, jemi munduar të ruajmë rezerva relativisht më të mëdha sesa vitet e shkuara që të ndërhyjmë edhe nga qendra kur të na ndodhin fenomene, të cilat do të jenë të pafalshme dhe të pakëndshme që ne të mos çojmë shërbimin te qytetari për një gabim që mund të jetë bërë nga një administratë, që do ta pëlqeja ta quaja, shumë të mirë, por që nuk i ka parashikuar dot të gjitha. Kjo është arsyeja që janë lënë fonde, në mënyrë që të ndërhyhet rast pas rasti për të gjetur zgjidhjet që kërkojmë. Pra, kjo është dhe jo ndonjë arsye tjetër. Është zbatimi i një formule, e cila ka funksionuar. Është e vjetër dhe i ka ardhur koha për t'u revizionuar, por ne nuk mund ta bëjmë përpara një viti i cili është i veçantë. Ju shpjegova që ky vit do të ketë edhe administrimin e veçantë. Nuk do të jetë një vit që do të japim të gjitha fondet, por do ta ndjekim si Ministri e Financave, bashkë me Ministrinë e Pushtetit Lokal muaj për muaj, tremujor për tremujor për të bërë rialokime, rivendosje, sqarime në mënyrë që qytetarit t'i shkojë shërbimi. Ky besoj është shqetësimi dhe jo shpenzimi i parave.

Fatmir Xhafaj - Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Klosi.

Blendi Klosi - Zoti Ministër, është e vërtetë që formula mund të jetë bërë që në vitin 2001 dhe ne së bashku e kuptojmë logjikën e formulës në kohë të ndryshme, por nga viti 2001 deri në vitin 2014 situata demografike e vendit ka ndryshuar me 2-3 herë.

Qarku i Durrësit apo bashkia e Durrësit ka ndryshuar nga viti 2000 në vitin 2014 me 4 herë numrin e popullsisë. Nëse për bashkinë e Durrësit në vitin 2000 për pushtetin vendor kanë votuar 40 mijë votues, sot votojnë 160 mijë votues. Pra, 4 herë ka ndryshuar numri i qytetarëve të Durrësit, për të mos folur për të gjithë qarkun e tij. Nëse logjika juaj qëndron te logjika e vitit 2001, apo tek ajo që më tha një nëpunësi juaj shumë i nderuar, që mbetemi se sa rrugë rurale ka qarku dhe ajo është formula që i shkon një qarku të caktuar, pavarësisht se me numër popullsie sesa një qark tjetër, dy herë më shumë buxhet, unë mendoj se edhe ju pranoni logjikën time, se kjo situatë duhet të ndryshohet. Ne i çojmë shërbimet apo investimet te qytetari. Nuk po flasim vetëm për Durrësin, por edhe për Tiranën që është qarku i dytë me më pak buxhet sesa qarqet e tjera. Nuk mendoj se Tirana ka më pak rrugë sesa Dibra.

Po i kthehem Durrësit. Kemi zona rurale që janë krejtësisht jashtë vëmendjes së investimeve nga qarku për mungesë financimi, ato janë zona që kanë një superdendësi të

popullatës, po flas për komuna si Ishmi, ato të rrethit të Krujës, ku ka një super popullsi, dyfishohen banorët, pra vazhdojnë të jenë me logjikën e vitit 2001.

Zoti Ministër, meqenëse e përmendët vitin 2001, mendoj se ka ardhur koha edhe në kuadër të reformës së re territoriale, por edhe të mënyrës së re që do të bëhen qarqet, që ta stoponi këtë formulë, jepni fonde deri në momentin që kjo ndarje do të jetë efciente. Ka super investime në qarqe me numër të vogël të popullsisë. Nuk thashë gjë pse jepen kaq shumë në Shkodër apo në Elbasan, sepse janë qarqe të mëdha ku numri i popullsisë nuk pakësohet por shtohet, por në qarqe të cilat kanë numër kaq të madh popullsie si Tirana, Durrësi apo qarku i Vlorës, nuk mund të jenë tri qarqet e fundit në listën e investimeve.

Zoti Ministër, rishikojeni, ne do t'ju mbështesim edhe si komision, nëse doni edhe nënkomisioni i pushtetit vendor pranë këtij komisioni, që ta ridiskutojmë. Formula mund të ketë qenë shumë e saktë në vitin 2001, mund të ketë qëndruar, por logjika e saj ka rënë prej shumë vitesh.

Fatmir Xhafaj - Kjo historia e formulës magjike u bë si formulë magjike, por askush nuk po e mban. Edhe ju sot i gjetët baba tjetër. Kishte vite që i thoshin ka PD-në, ka PS-në, ju tani gjetët USAID-in.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shkëlqim Cani - Zoti Xhafaj, jam i detyruar të flas me korrektesë dhe të parashtroj atë që është. Dikush këtu ka të drejtën, pasi është edhe media që ta verifikojë.

Fatmir Xhafaj- Më vjen keq, unë nuk e vë në diskutim. Këtu nuk është çështja se kush është shpikësi i formulës. Këtu po pyetet: a është efektive kjo formulë? A ka nevojë të ndryshohet në këto kushte? Përgjigjuni për këtë!

Ju jeni ekspert i fushës, dhe, nëse do të hyni në këtë histori të gjatë, i bie t'ju dëgjojmë vetëm juve dhe të mos të dëgjojmë të tjerë. Kjo është edhe për efekt kohe. Për thelbin keni të drejtë ju. Mund të vazhdoni, por e kisha edhe për të ekonomizuar kohën.

Shkëlqim Cani - Zoti Xhafaj, kjo çështja e kohës na është kthyer në një problem të madh dhe e mirëkuptoj, por edhe neve duhet të na jepni kohën e mjaftueshme për të qenë të qartë me ju dhe me publikun.

Ajo që parashtrova është se formula është e hershme. Pra, jam dakord, por ne nuk erdhëm në pushtet në vitin 2011 që unë ta ndryshoj, por erdhëm në vitin 2013 dhe nuk patëm

hapësira për ta bërë për vitin 2014. Për vitin 2015 e gjykuam se nuk ia vlen të ndërhyjmë, sepse mund të gabonin potencialisht, pasi jemi para një gjendje ku pushtetet po ndërrojnë thelbësisht nga ana e ristrukturimit dhe që të marrim për bazë shumë faktorë të tjerë do të na duhet të kemi një vizion shumë të qartë se çfarë do të ndodhë në praktikë lidhur me pushtetin, ndërsa brenda formulës është e sigurt që ndryshimi i popullsisë ka sjellë defekte, sepse formula është e ftohtë dhe janë marrë regjistrimet e reja. Sa herë ka pasur regjistrime, janë pasqyruar.

Tani, ka një ndarje shumë të qartë të asaj që i jepet një qarku dhe asaj që i jepet një bashkie brenda qarkut. Bashkia e Durrësit ka fonde me herë më shumë se një bashki tjetër në një vend tjetër, le të themi në Dibër, por qarku është më i gjerë. Lidhur me qarkun ne mendojmë që edhe qarkun ta kufizojmë në dhënien e fondeve gjatë vitit 2015 dhe të japim ato fonde që janë të domosdoshme për ta mbajtur gjallë, sepse bëjmë fjalë, supozojmë, qarku i Durrësit me të Dibrës, ka një veçori; në qoftë se, për shembull, bllokohen rrugët nga dëbora, këtu qarku i Durrësit mund të pranojë edhe ndonjë gabim, kurse atje janë gabime fatale. Kështu që, ne jemi menduar, kemi diskutuar dhe debatuar gjerë e gjatë për të gjitha këto, por të mos ngatërrohen fondet për një qark, që janë shumë të vogla, krahasuar me sa u jepet bashkive. Koncepti im për qarkun është që, kur i bashkojmë të gjitha: qark, bashki etj, dhe i vëmë në një fond, në një peshore nga një krah dhe nga një krah tjetër.

Pra, qarku në vetvete nuk mund të shpëputet nga bashkia, sepse në qoftë se i merr një bashki fondet, supozojmë Durrësi; ne po japim gjithë atë fond, nga banka Botërore, për ujin e pijshëm. Tani, si do të arrij ta llogaris unë? Pse po merr Durrësi kaq para? Po, sepse është synimi i qeverisë, se uji është prioritet, dhe do t'ia japim Durrësit, sepse Durrësit i mungon uji. Si do të them unë? Bashkisë së Durrësit t'i llogaris se sa para po të jap për ujin dhe të të heq paratë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale? Jo, nuk do ta bëj dot këtë, sepse uji është një politikë shumë më e madhe.

Këto janë pasur parasysh gjatë tërë këtij diskutimi dhe gjatë tërë kësaj hapësire. Ju mirëkuptoj dhe ju kërkoj ndjesë, por është e pamundur ta bënim. Këtë po them: ne jemi munduar të gjejmë atë që na u duk më racionale, që për vitin 2015 të mos e ndryshojmë të famshmen formulë; natyrisht, e theksoj edhe një herë, bashkë me komunitetin ndërkombëtar dhe me organe të specializuara që e shohin më ftohtë këtë gjendje, sepse ju thashë edhe herën e parë: ne mundet

që sot të marrim kritika këtu, në këtë ambient, por opozita nuk është, të tjera kritika do të marrim.

Ndarja në pushtetin lokal, e kuptova se është për t'u goditur nga të gjithë krahët dhe nuk pres të marr ndonjë vlerësim pozitiv, edhe pse ju them s pushtetit lokal i kemi dhënë gjashtë herë më shumë rritje se sa i është dhënë gjithë buxhetit të ekonomisë shqiptare. Pra ne kemi bërë një hap cilësor për vitin 2015. Po ju them se jemi përpara të papritura dhe kemi shqetësimin e madh që këto para të përfundojnë në shërbim për qytetarin. Ky është shqetësimi madhor. Natyrshëm që unë i kuptoj të gjitha shqetësimet që kanë deputetët, por këto ishin mundësitë, këto ishin vlerësimet. Deputetët janë të mirëpritur në qoftë se kanë ndonjë sugjerim konkret për të ndërruar diçka, por nuk shkon që ne të ndërhyjmë kur jemi përpara një ndryshimi që është shumë herë më i madh se një formulë. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër, për shpjegimin konkret!

Zoti, Fino, keni diçka? Po.

Bashkim Fino – Zoti kryetar, do të më lejoni, se kjo është pjesa më kryesore e buxhetit, që mbulon në fakt komisioni ynë, sepse institucionet e tjera të pavarura janë institucione që në përgjithësi kanë gjetur rakordimin e nevojshëm me Ministrinë e Financave. Në fillim dua të falënderoj Ministrin e Financave, i cili vjen vetë këtu për të mbrojtur pikërisht buxhetin e pushtetit vendor.

(Diskutime pa mikrofon)

E vlerësoj këtë, për të treguar një gjë shumë interesante: pushteti vendor është shumë i rëndësishëm. Ky komision e mbulon pushtetin vendor. Është e vërtetë siç tha Ministri. Unë do të bëj sugjerime, të cilat Ministri t'i mbajë parasysh, sidomos nen për nen apo edhe Komisioni i Ekonomisë, që është rritur gjashtë herë buxheti i pushtetit vendor, dhe nuk kemi pse ta falënderojmë sepse po bën detyrën. Ashtu siç është rritur 3% ekonomia shqiptare – pretendoni të rritet – kuptohet se edhe buxheti i pushtetit vendor duhet të rritet minimalisht tre deri në gjashtë herë, dhe ju e keni rritur gjashtë herë.

Në pjesën hapëse unë nuk kam asnjë vërejtje, dhe më duhet t'ju falënderoj, sepse nga 33,1 miliardë lekë, ju propozoni që në buxhetin e vitit 2015 të jenë 41, 2 miliard lekë. Por, një njeri që e shikon në pamje të parë buxhetin, thotë: nuk ka si Shkëlqim Cani – më fal që po të drejtohem në emër; mos më keqkupto, se jemi edhe miq bashkë –, nuk ka! Bravo i qoftë!

Megjithëse kjo qeveri nuk ka ministër funksional që të mbulojë vërtetë pushtetin vendor, në kuptimin për të ndjekur pushtetin vendor, sepse pak më përpara ishte Ministri i Brendshëm, që mbulonte tre sektorë, jo emergjencat, jo prefekturat etj., por prapë ia vlen të thuash: shumë mirë. Pastaj, kur i hyn dhe e shikon me syrin e specialistit dhe bën një analizë të shifrave, të rezulton se decentralizim nuk ka.

Pra, lekët janë, fondet janë, ju i jepni, ne ju falënderojmë, ato në fakt te komuniteti do të venë, pra do të venë të kryetarët e komunave e të bashkive, te komuniteti, por po ta marrësh nga pikëpamja e decentralizimit, këtu mua, më lejoni t'ju them, nuk keni bërë asnjë hap përpara, por jeni në po atë nivel që ka bërë Ridvan Bode apo dhe kryeministri i mëparshëm.

E kam fjalën për fondin e rajoneve. E kam fjalën për një fond, të cilin ju sot e keni planifikuar rreth 2 miliardë lekë për vitin 2015, shumë mirë, madje e keni planifikuar edhe më shumë se viti i kaluar. Unë jam i bindur, siç ju thashë, se ato me atë politikën e qyteteve inteligjente, që vënë në investime për qytetet, prapë te komuniteti do të venë, por në aspektin e decentralizimit, ato janë fonde të pushtetit vendor, që ju i llogarisni te ajo shifër, që është gjashtë herë më e lartë për pushtetin vendor. Në fakt nuk e ndan pushteti vendor atë punë, por e ndan qeveria për pushtetin vendor, dhe ju ia fusni në përqindje, pra gjashtë herë më shumë që e ka pushteti vendor.

Zoti Ministër! Unë do ta kërkoj me forcë, edhe në diskutimin në parim, në parlament, që çështja e fondeve të rajoneve, një çështje e mbrapshtë e qeverisë së mëparshme, duhet të rregullohet sa më shpejt. Nuk jam kundër për të mbajtur fond si qeveri, dhe për të ndërhyrë në komunitetet tona në një moment të caktuar, kur bashkitë s'kanë mundësi financiare. S'jam kundër kësaj. Jam pro që të ketë diçka të tillë. Pra s'jam totalisht kundër. Por nuk mund të jem pro që ajo të ketë shenjën e barazisë midis grandit të pakushtëzuar dhe grandit që ndahet nga qeveria. Këtu nuk jam dakord dhe këtu, besoj se edhe ju më mirëkuptoni, që ne duhet të bëjmë një qasje të re në 2016-en.

Vazhdojmë më tej. Ky projektbuxhet ka vërtetë një rritje, siç thoni ju, nga 2, 4% e GDP-së në 2,76 apo 2, 8 e GDP-së, por prapë synimet tona, synimet e qeverisë sonë, synimet e kësaj maxhorance që ka bërë edhe reforma, janë për më shumë, sepse kjo GDP dhe ky raport përqindjeje është shumë i vogël në rajon. Mos harroni se kemi bërë një reformë shumë të madhe, që mbase rajoni s'e ka bërë sa dhe si duhet, dhe ndërkohë që pretendojmë të vemi në Europë,

atëherë duhet ta rrisim këtë lloj performance. Megjithatë, prapë është për të falënderuar, sepse të vejë nga 2.4 në 2.8 është një gjë shumë pozitive dhe unë nuk mund të mos them fjalë të mira.

Gjithashtu, unë mendoj se ky projektbuxhet ka nevojë të rishikohet. Vijnë te granti i famshëm, për të cilin ju bëtë debat. Është një debat, të cilin të gjithë deputetët, po të ulen e të shikojnë komunat apo bashkitë që mbulojnë, të gjithë do të kërkojnë të marrin sa më shumë nga vetja.

Unë mendoj, zoti ministër, se e pëlqej argumentin tuaj. Është argument bindës, madje dua të them se është shkatërrues në sensin e tij, por shkatërrues që edhe argumenti që ne dhamë para një viti, kur ju thamë: “zoti Ministër, ndryshojeni mënyrën e përlogaritjes së granteve” dhe ju na dhatë fjalën se do të ndryshohej. Ndërkohë, vini me këtë formulë, të pandryshuar, me argumentin se do të bëhet një organizim i ri vitin tjetër, gjë për të cilën keni plotësisht të drejt dhe s’kam çfarë ju them. Sinqerisht s’kam çfarë ju them, sepse edhe unë po të isha në vendin tuaj, do të thosha: për gjashtë muaj që do të venë fondet në buxhetin vendor, unë nuk mund të ndërroj një formulë, kur kam mundësinë të ulem me USAID-in apo edhe me pozitën e opozitën, që të bëj një formulë për së mbari për ndarjen e granteve për 61 bashki nesër. Nga kjo pikëpamje logjike, ju keni të drejtë, por nga pikëpamja praktike e deputetëve, më duket se kanë të drejtë ata, sepse po t’i shikosh fondet e ndarjes së buxhetit e sidomos të granteve, kanë një disproporcion.

Zoti Ministër! Unë do t’ju them një dhe, dhe ju duhet ta rregulloni patjetër me Komisionin e Ekonomisë: granti i pakushtëzuar në vlerë absolute, është më i vogël në raport me vitin 2014. Më lejoni t’ju lexoj, zoti Ministër, se transferta e pakushtëzuar është 13,3 miliardë lekë në 2014-en, dhe në vitin 2015, zoti Ministër, po të marrim 12,4 milionë lekë, që keni vënë ju, hiq 1,2, që na e keni lënë te aneksi numër 1, që kërkon ta mbani si fond rezervë ëpr ndarjen territoriale, i ngelen 11, 2 miliardë. Domethënë, si grant i pakushtëzuar, në raport me vitin 2014, kemi diçka më poshtë. Duke qenë më poshtë se viti 2014, automatikisht, të gjithë kolegët e mi janë të pakënaqur. Pse? Sepse po të shikosh komunat dhe bashkitë e ndarjes së grantit të pakushtëzuar, të gjitha janë pak me minus.

Cili është efekti, që ne bëjmë politikë këtu? Efekti është shumë i saktë. Vërtet që formula është bërë në 2001-shin, është bërë në kohën tonë dhe është bërë me USAID-in, por që nga 2001 e deri në 2014-en, ata zotërinjtë që qenë përpara në pushtet e kanë bërë ndarjen e grantit të pakushtëzuar sipas dëshirës, dhe ato fonde kanë ngelur.

Më lejoni t'ju sjell një shembull, zoti Ministër. Po ju sjell një shembull shumë strategjik, shembull të cilin e kam bërë edhe vjet e do ta bëj edhe sivjet, e do ta bëj edhe sivjet me dhimbje, zoti Ministër! Unë nuk mund ta kuptoj që një komunë maqedonase të marrë 22 deri në 23 milionë lekë grand të pakushtëzuar. Po pse? Sepse është trumbetuar nga ata që kanë qenë vjet e parvjet në pushtet dhe ia kanë dhënë me shumicë. Ndërkohë, një komunë tjetër, po them kot, Hudenisht, merr më pak, apo bashkia Maliq merr më pak në raport me këtë. Pse? Se në momentin që Ministria e Financave vë një skalion të caktuar, thotë 20 milionë, mbi bazën e kësaj, kur rritet buxheti 3 % – ju e dini shumë mirë – i shtoni 3% mbi to dhe vazhdon me këtë llogaritje vit pas viti. Dhe çfarë më rezulton tani me këtë? Më rezulton se ky granti i pakushtëzuar, që në vlerë absolute është pak më i vogël nga granti i pakushtëzuar i vitit 2014, më rezulton të jetë më i vogël në disa komuna e bashki të Shqipërisë.

Unë mendoj se kjo ka një zgjidhje. Cila është zgjidhja? Zgjidhja është, zoti Ministër, që 1,2 miliardë lekë, që ju keni lënë në aneksin numër 1, për fondin zhvillimit të reformës territoriale, unë mendoj se duhet t'i kthehen grantit të pakushtëzuar. Në qoftë se e shpiem këtë, të paktën barazojmë grantin e pakushtëzuar me grantin e rajoneve. Të paktën kemi një mundësi dhe një hapësirë shumë ekselente, le të themi, që të bëjmë disa rregullime të disa komunave të cilat kanë vërtetë – siç thoni ju – rrugë rurale më shumë, numër popullsie, dhe që mund të marrin një lloj granti.

Nga ana tjetër, zoti Ministër, në diskutimin tim dua të përmend edhe një çështje shumë kardinale, çështja e aneksit 6, të cilin edhe ju e prekët, edhe unë e preka, por unë po ju them një gjë.

E para e punës një herë, unë jam plotësisht dakord me pikën e parë, ku ju thoni se “transferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe komunat do të ndahet në muaj dhe në tremujorë”. Kjo duhet të jetë kryefjala me germa kapitale në buxhetin e vitit 2015.

Më lejoni t'ju bëj një vërejtje dhe mbajeni shënim, ta mbajnë shënim edhe këshilltarët tanë, që ju këtu keni harruar pa vënë qarqet. Duhet të futni edhe qarqet. Pra: “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë, komunat dhe qarqet”, se edhe qarqet janë në kuadër, duhen vënë “...duhet të ndahen në muaj dhe në tremujorë” dhe atë e kontrolloni, e gjykoni dhe e vendosni ju për ta vazhduar më tej, por unë jam i mendimit, do t'ia propozoj edhe Komisionit të Ekonomisë, që aneksi 6, pavarësisht përpjekjes së mirë që ju keni bërë për shkak të reformës që do të bëhet

për pushtetin vendor, që ky aneks 6 duhet të grupohet më afër, të bëhet pak më i përmbledhur, të mos jetë në formën e udhëzimit, të vihen vetëm dy-tre pika dhe t'i lihet mundësi dhe hapësirë, ashtu siç kam propozuar unë, jo pse jam më i zoti, por sepse është më mirë, sepse do të ketë shumë probleme për implementimin e ligjit të ndarjes territoriale në Republikën e Shqipërisë vitin që vjen. Pra, të ketë një grup pune dhe në kuadrin e shtimit të njerëzve, unë propozoj të shtohen dhjetë veta te ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor për t'u marrë me këtë çështje dhe që të kemi mundësi ta implementojmë ligjin sa më saktë. Përndryshe, unë jam i detyruar të them dhe të bëj pyetjen: çfarë bëhet me paratë që kursejmë nga reforma territoriale, zoti Ministër, dhe e kemi trumbetuar me të madhe, unë, ti dhe (min 1:52) kemi kursyer 60-80 milionë dollarë në vit? Pra, në qoftë se ne kursejmë 60 milionë dollarë në vit, nuk na kushton asgjë të vëmë dhjetë inspektorë për të implementuar ligjin e ndarjes territoriale, që është shumë i rëndësishëm dhe nuk mund të përfundojë për një muaj, dy muaj, por do një kohë më të gjatë për ta implementuar këtë projektligj. Edhe kjo është një çështje që duhet të trajtohet nga ana juaj.

Tjetra që kam, zoti Ministër, neni 15 është në buxhet, por le të pretendojmë se do të jetë për herë të fundit i vendosur kështu rishtazi për shkak të ndarjes së re territoriale, për shkak të performancës që do të kenë 61 kryetarët e bashkive vitin që vjen dhe nuk mund të vendosim më tanimë klauzola që kaq për qind do të përdoren për administratën dhe kaq për qind për investime e kështu me radhë, se mua më duket se këtu ndërhyjmë me të drejtë në kompetencat e tyre. Madje pak më përpara, thatë se “ne nuk kemi llogaritur...”, ju dëgjova edhe dje me kujdes te Komisioni i Ekonomisë “...borxhet që mund të kenë pushtetet vendore dhe nuk i paguajmë borxhe pushtetit vendor”. Absolutisht, por ama e ke marrë të drejtën të shkruash në projektligj që “në qoftë se pushteti vendor ka borxhe kundrejt ujësjellës-kanalizimeve tremujorin e fundit unë do t'i ndërpres grantin”. Çfarë është kjo? Kjo është një masë shtrënguese që ti merr. Në fakt, ti i thua: “Nuk t'i paguaj”, por në fakt i thua “i pagan”, sepse ia merr grantin e tremujorit të katërt dhe i thua: “Për shkak se ke borxh në ujësjellës-kanalizime” dhe ky është një aksion shumë i madh që bën qeveria, “...unë t'i marr këto fonde për t'ua kaluar bashkive dhe komunave”, dhe shumë mirë. Kjo do të thotë se neni 15 për vitin tjetër duhet të rishikohet dhe kam besimin se duhet të rregullohet përfundimisht.

Nga ana tjetër, dua të flas për ndarjen e fondeve që bën në të famshmin formularin nr.2 që ke këtu, aneksin 2 në mos gabo, të qarqeve, rajoneve. Më lejoni t'ju them se jam dakord me

këto siç thashë, por jam dakord me një sasi të konsiderueshme të vogël fondesh dhe jo me një sasi të madhe, e cila të jetë e barasvlershme me grantin e pakushtëzuar, sepse nuk mendoj se kjo është kryesore.

Tjetër problem që dua ta trajtoj, zoti Ministër, është një problem shumë i rëndësishëm që unë kam.

Kur u bë qeveria “Rama”, me thënë të drejtën unë u ndjeva mirë kur u vu një ministër Shteti për Çështjet Vendore, edhe për shkak të politikave, edhe për shkak të reformës që ne duam të bëjmë dhe e bëmë, e kupton, dhe mendova se u rikthye balanca, sepse sapo e thatë ju këtu se ka një përqindje shumë të madhe buxheti i shtetit për pushtetin vendor dhe është një nga buxhetet dhe që ju si ministri e Financave hasni më shumë vështirësi jo vetëm në bërje, por edhe në diskutime, sepse keni të bëni tanimë jo më me një apo dy njohës të fushës së shëndetësisë, të arsimit apo të transportit, por keni të bëni me 140 deputetë të cilët mbulojnë komunat/bashkitë dhe ka të bëjë me grantin. Është një buxhet shumë më i diskutueshëm që gjithmonë ju keni problem.

Çfarë kam vënë re gjatë gjithë kësaj kohe? Kam vënë re dhe kam parë edhe organigramën tuaj, zoti Ministër, të Ministrisë së Financave dhe të të gjitha ministrive dhe kam konstatuar që në organigramat tuaja mund të ketë shumë drejtori, shumë sektorë dhe shumë njerëz; është çështja juaj sesi e drejtoni ministrinë, por vetëm strukturë për financat dhe për buxhetin e shtetit, për buxhetin lokal nuk ka. Nuk ka as te ju, as te ministri për Çështjet Vendore, as te ministrat e tjerë.

Tani, jo më kot, kam kërkuar dhe kam parë në Europë, ku 90% e vendeve kanë ministri, madje disa prej tyre kanë sekretariat. Madje disa prej tyre që nuk kanë ministri, sekretariat, kanë departament të financave të buxhetit vendor. Ndërkohë, ne kemi ministër për të bërë politika për pushtetin vendor, e ngarkojmë edhe me antikorrupsionin dhe bëjmë shumë mirë, kemi një Ministri të Financave që ju, për hir të së vërtetës, keni lënë një njeri që e njeh pushtetin vendor. E keni lënë atje dhe punon për këtë çështje, por që duhet ngritur në nivel departamenti të një drejtorie shumë të rëndësishme, në kuadrin e ristrukturimit në funksion të buxhetit flas gjithmonë, zoti Ministër, dhe më lejoni t’ju them se kjo është një njohje shumë e mirë imja që po ju sugjeroj ta ndryshoni dhe nuk e keni bërë. Nuk e keni bërë ju, si ministër i Financave; nuk e ka bërë ministri për Çështjet Vendore. Atëherë, më lind natyrshëm pyetja që mund t’ju bëj ju, zoti

Ministër: kush merret me problemet e shpronësimit të pushtetit vendor? Si ndiqen në mënyrë periodike performancat e ardhura nga pushteti vendor, prej të cilave ka një performancë më të madhe apo më të vogël në mbledhje, që duhet ta ndjekë edhe pushteti qendror? Kush dhe si bëhet monitorimi i buxhetit vendor në mënyrë periodike? Duhet të bëhet se s'bën ky monitorim? Kush merret me transfertat e buxhetit vendor? Pra, janë një sërë pikëpyetjesh, pale më të shkosh te ligji i ri që kemi për ndarjen territoriale që kush do ta bëjë implementimin e atij ligji, që ka të bëjë edhe me ju si Financë për pjesën tuaj të financës, por ka të bëjë edhe me një sërë ministrish të tjera, se është një reformë historike, e thamë, strukturore e shtetit. Vërtet bëme të pushtetit vendor, por është e shtetit, se do të ndikojë tek arsimi, te shëndetësia, te policia, te financat, tek të gjitha me radhë. Do t'i kemi në funksion të këtyre 61 bashkive.

Të gjitha këto që thashë, të gjitha këto pyetje që bëra dhe nuk kërkoj të marr përgjigje, zoti kryetar, tregojnë që nuk kemi një gjë të zgjuar të bërë edhe nga ju, si ministër i Financave, pavarësisht se mu desh të falënderoj disa herë për shkak të aneksit 6, që jeni munduar të bëni diçka, por nuk keni bërë asgjë. Por dua të them se duhet të zgjidhni sa më shpejt një drejtori kryesore për pushtetin vendor pranë Ministrisë së Financave, një departament brenda strukturimit tuaj. Fatin e madh e keni, sepse keni shtuar 35 njerëz në ministrinë tuaj. Vini 5-6 veta në këtë drejtori. Bëjeni këtë drejtori, të ndiheni edhe ju mirë, që pastaj kur të vijë ai drejtori këtu, t'i thotë Klosit: “Urdhëro, si është formula. Kaq është numri i punonjësve. Kaq është numri i popullsisë. Kaq është numri i rrugëve. Kaq janë bizneset”.

E merr edhe Klosi, edhe unë dhe bëjmë menjëherë veprimin, se formulë është ajo. I shumëzohet, i pjesëtohet dhe themi: e kanë nxjerrë në rregull shumën këtu? E kanë nxjerrë në rregull shumën këtu dhe nuk kemi pse kërkojmë llogari. Por po ta bësh një gjë të tillë, do të ecim në rregull. Fakti që nuk e keni bërë dhe e keni lënë kështu, ka mundësi që edhe të kamufloni, të bëni gjëra që bëni sikur ne nuk i kapim dot, por, në fakt, ju ka gjetur belaja e madhe, sepse ne i kapim dhe i kapim shumë mirë, sepse janë të shënuara këtu dhe duhen hequr.

Në konkluzione, zoti kryetar, unë kam këto sugjerime për të bërë për buxhetin vendor.

E para, duhet të ikë 1,2 milionëshi dhe të ndahet për të gjitha komunat dhe bashkitë për grant të pakushtëzuar. Pra, nuk ka pse të ngelet fond në zbatim të reformës së re administrativo-territoriale.

E dyta, në qoftë se ka mundësi nga Komisioni i Ekonomisë që granti i pakushtëzuar të jetë më i lartë, po e theksoj dhe po e ngre zërin, më i lartë se granti i qarqeve, në fakt i grantit të investimeve që jep qeveria, do të ishte shumë herë më mirë dhe nuk mund të ishte i barabartë, siç e kemi këtu 12,2 me 12,4 miliardë, apo jo, që janë njësoj të barabarta.

Propozimi tjetër. Unë jam kundër aneksit 6 dhe jam thjesht për një fjali në aneksin 6, madje le të vihet nën më vete, jo aneks, ku transferta e pakushtëzuar për bashkitë, komunat dhe qarqet që duhen shtuar, se nuk e keni vënë, të ndiqet çdo muaj nga Ministria e Financave dhe në tremujor. Kjo do të bëjë të mundur ndjekjen e atyre 6-7muajve që bashkitë janë, këto bashkitë e vjetra sa të dalin bashkitë e reja, e kupton? Duke vënë këto ndryshime, kam përshtypjen që bëjmë një lloj rregullimi, pastaj ndarja u takon specialistëve për ta bërë, një qetësim të situatës për ndarjen e buxhetit të pushtetit vendor. Kjo do të bëjë të mundur për ta parë pastaj kur të vijë nën për nën.

Në të kundërt, unë kam vërejtje shumë thelbësore për aneksin 6, kam vërejtje thelbësore për aneksin 1 (1,2 miliardëshin) dhe vërtet do të kërkoja mirëkuptimin e ministrit, ashtu siç edhe ne e mirëkuptuam që i pranuan disa gjëra, qoftë formulën që do të ngelet kjo që është, se nuk kemi çfarë t'i bëjmë se do të ndërrohet, qoftë reforma që do të bëjmë vitin tjetër dhe që çdo muaj duhet të kontrollohet nga Ministria e Financave, apo qoftë edhe këto të dhëna që, pavarësisht se janë 6 herë më shumë, siç thotë ministri me të vërtetë, por në fakt po ta marrësh ta shohësh, është po ajo që kemi ndarë në vitin 2014 për sa i përket asaj.

Gjithashtu duhet t'u jepni zgjidhje përfundimisht edhe qarqeve. Në qoftë se ju te neni 15, zoti Ministër, thoni se "15% e transfertës së pakushtëzuar do të kalojë për shpenzime administrative të qarqeve", kjo do të thotë se qarqet do të kenë vetëm 10 punonjës, nuk do të kenë më nga 60-70.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po, por mund të keni probleme me nëpunësit që janë me statusin e nëpunësit civil. Duhet të keni mundësinë të konsultoheni.

Jam dakord që të shkurtohen. Jam absolutisht dakord. Nuk mund të rrinë 60-70 veta kur nuk bëjnë asgjë, por jam i detyruar t'ju them se ndoshta do të ishte mirë që edhe kjo të korrigjohej, të bëhej 20% që të vinte shkallë-shkallë. Jo nga 70 në 10, por nga 70 mund të ishin 15 punonjës në vazhdim. Pra, janë mendime, sugjerime të cilat ju keni kohën e nevojshme të

reflektoni, të na jepni përgjigje deri në momentin që ne e kalojmë në parim, por pastaj kemi edhe një javë kohë, deri në datën 27 kur ne ta kalojmë nën për nën, sepse nënet përkatëse do të ndryshohen dhe aty do të kuptojmë me të vërtetë që ju i keni marrë parasysht apo jo.

Do t'ju lutem shumë që: jepi frymëzim në ministrinë tënde një strukturë të re të ministrisë duke krijuar një departament të vërtetë për pushtetin vendor dhe të financave.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Ministër, si rregull ne e kemi që po foli relatori, nuk flet më njeri tjetër, por, zoti Qefalia kërkoi mirëkuptim dhe pastaj ju i bëni bashkë që ta mbyllni. Do të më falni, ju kërkohet ndjesë!

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ministër, unë e kuptoj dëshirën tuaj të mirë për të qenë transparentë në ndarjen e buxheteve. Në fakt, unë përfaqësoj një zonë e cila në ndarjen e re administrative është përfshirë që do të jetë pjesë e qytetit të Tiranës. Do të isha kurioz, se unë, në fakt, nuk e njoh formulën dhe as nuk pretendoj ta njoh ndonjëherë këtë formulë e famshme, por duke marrë shkas nga diskutimi i zotit Klosi e quaj me vend, ndaj do të doja t'ju bëja pyetjen drejtpërdrejt: a është pasur në konsideratë numri i popullsisë së këtyre zonave, të cilave u kalon ky grant? Po marr një shembull të thjeshtë, nuk dua t'i paragjykoj zonat, pasi në kohën e Berishës parashikoheshin zonat kur ish-ministri Noka thoshte: “Shtohet popullsia në Kukës për efekt votuesish”, unë e kam konkretisht: në ndarjen e granteve që janë bërë, marr komunën e Vaqarrit ose të Pezës, shikohet se ka një grant që shkon gati 15,444 dhe marr një komunë tjetër, po të duash ta marr në Peshkopi, por mos më keqkupto, ose në Bulqizë. Zërqani e ka po me të njëjtën gradë ku numri i popullsisë së tyre ndryshon. Po e njëjta gjë ndodh në një komunë të një fshati në Tropojë, ku shkon gati dyfishi i komunës Pezë.

Dua të di zoti Ministër, se kur është marrë statistika e këtyre zonave. A është pasur në konsideratë kohët e fundit apo vazhdon, sipas formulës së vjetër që është? Në fakt këtë përgjigje do të doja dhe do të isha shumë i interesuar ta dija, sepse nga informacionet dhe kontaktet që kam pasur në zonë, shumë nga banorët e këtyre zonave janë lënë në harresë edhe pse janë zona të qarkut të Tiranës, janë zona po aq të thella, sa ç'është edhe Bytyçi në Tropojë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

E mbyllem këtu këtë pjesë dhe ia lëmë fjalën ministrit, për të bërë komentet.

Shkëlqim Cani - Meqë pyetja është shumë e drejtpërdrejtë edhe përgjigja është: të dhënat për popullsinë janë marrë në gusht të vitit 2014, sipas evidencave të MPB-së. Do t'ju lutem të gjithë deputetëve, pavarësisht se është diskutim në parim, natyrisht, nuk mund të flitet për një komunë apo një qark. Jemi të gatshëm si Ministri Financash, që çdo fshat ta zbërthejmë formulën një për një. Nëse gjykoni se është bërë një gabim, ka kohë për t'u rregulluar. Ua premtoj rregullimin, por me një kusht që do t'i rrimë formulës dhe nëse gjendet një gabim, jemi të gatshëm ta rregullojmë. Natyrisht, që statistikën janë zyrtare, se s'mund të marrim statistika të tjera jashtë shtetit. Pra, shteti na jep një evidencë dhe ne e respektojmë atë. Nuk ka formula, të cilat janë bërë dikur dhe u shtohet apo u hiqet 3%. Çdo vit formula ribëhet nga fillimi. Merren parasysh (janë 6 faktorë, por s'po u hy në detaje). Kjo është përgjigja në parim.

Zoti Fino, kisha hall të dëgjoni njëri-tjetrin, se po biem dakord në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

E mirëkuptoj zotin Fino, për rishikim strukturë në Ministrinë e Financave deri në këtë nivel, se besoj që secili nga ne, do të flasim në parim për këtë çështje. Ne e kemi vetë parasysh numrin, që kërkojmë shtesë. Se çfarë do të jetë, kjo është një çështje që do të duhet të zgjidhet edhe me Ministrinë e Pushtetit Vendor, sepse kur u përgatitën ato struktura, kishim koncepte të ndryshme për kohën. Diskutuam se do ta marrë pushteti lokal dhe s'kishte se përse duhej një strukturë paralele. Tani po e rishikojmë. Pra, biem dakord në parim.

Lidhur me nenin 15, për shpenzime administrative e investime, besoj se biem dakord të gjithë në parim, që synimet e pushtetit lokal duhet të jenë drejt investimeve dhe shërbimeve për publikun, jo për të shtuar administratën. Zoti Fino, kërkoj mirëkuptimin tuaj për vitin 2015, meqë jemi një vit zgjedhor dhe një vit që pas zgjedhjeve, të kemi disa kompetenca dhe le t'i lëmë disa tregues për 2015-en, në mënyrë që të mos bëhen politika parazgjedhore, të cilat jemi mësuar të bëhen kështu që, le ta lëmë këtë vit, le të na rrjedhë, por me mirëkuptimin që në vitin 2016, do ta rishikojmë edhe këtë.

Besoj se biem dakord edhe për këtë.

Lidhur me Aneksin 6, që të jetë më i përmbledhur, unë tani nuk mund t’u premtoj. Ne e morëm seriozisht, se janë vërejtje dhe sugjerime jemi ambientuar me vetveten. Unë jam dakord që të bëhet një përmbledhje dhe ju mirëkuptoj për këtë, sepse në fakt në parim biem dakord të dy palët që viti 2015 do të ketë diçka që ende nuk përfytyrohet saktë, siç ishte viti 2014 pavarësisht, se sapo erdhëm në pushtet, e dinim se sa janë bashkitë komunat etj.

Në vitin 2015, marrim Klosin, ka apo s’ka godinë do të gjejmë godinë dhe do të kemi probleme të këtij lloji. Ju me të drejtë do të thoni, se kaloi gjithë kjo kohë. Tani ne s’mund t’i japim përgjigje kryetarit të ri të Bashkisë : “Ku ishte ti? Ç’më duhet mua! Rri në çadër!”

Kërkoj mirëkuptim nga të gjithë deputetët, që vitin 2015 ta lëmë me fonde, ku qeveria mund të ndërhyjë. Po na i dha të ndara të gjitha, të ndara me pushtetin lokal, s’kemi më të drejtë dhe do të ndodhemi para ngjarjeve, të cilat s’do të jenë të këndshme për asnjërin nga ne. Ky do të ishte mirëkuptimi. Në parim bie dakord me ju, por lëreni vitin 2015 me ndonjë rezervë për qarqet. Është e kotë që ta zgjas më tej. Kështu që formula e thashë edhe një herë duhet të jetë e saktë. Kuptoj që lidhur me pushtetin lokal që ka forcë për ndarjen e fondeve, le t’ia lëmë këtë forcë për t’ia ridhënë, siç i takon, por ama paratë ia dhamë dhe ia dhamë shumë.

Zoti Fino, në parim jemi në një mendje. Ju thatë se më kot e keni vënë shtatorin, kur paska për t’u mbledhur këshilli për të vendosur, sepse s’janë të ambientuar me buxhetin etj. Meqë u duhet kohë: këta që do të largohen, sepse do të bëhen zgjedhjet, dhe këta që vijnë, janë ende në fillim të marrjes së pushtetit dhe në fillim do të merren me çështje organizative etj. dhe do të na e lënë buxhetin pas dore. Pushteti qendror që e ka këtë eksperiencë dhe me këtë forcim që s’mund të marr përsipër, por kam dëshirën e mirë që i bëhet pushtetit lokal, do të kemi mundësi me ndërhyrje me VKM të shpejta, por po s’lamë para, natyrisht, që nuk ndërhyjmë dot. Kërkojmë mirëkuptimin për vitin 2015 dhe viti 2016, ashtu siç e mbajtem shumicën e zotimeve në fakt, siç e përmendët zoti Fino, se krijohet nganjëherë konfuzion edhe për medien, të gjitha këto hapa madhorë, që janë bërë në drejtim të buxheteve të pushtetit lokal, t’i vijojmë më tej, por për veçoritë e vitit 2015 doemos kur të kemi administratë të konsoliduar, të fiksuar dhe të miradministruar, doemos që do t’i kalojmë ato, sepse ato s’i takojnë më pushtetit qendror por i takojnë atyre që e kanë marrë votën dhe duhet të përgjigjen për votën që kanë marrë, në të gjitha drejtimet.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se me këto reflektime tejet konkrete të ministrit të Financave, besoj se kolegët deputetë janë të kënaqur me përgjigjet që morën.

Edhe njëherë, faleminderit, zoti Ministër për prezencën tuaj!

Faleminderit, zoti Ministër, për impenjimin personal shumë konstruktiv në reagim të shqetësimeve, pyetjeve dhe komenteve të deputetëve!

Unë shpresoj dhe besoj fort, që ato çfarë u thanë këtu, do të reflektohen gjatë procesit të shqyrtimit nën për nen të projekt-buxhetit.

Edhe njëherë, faleminderit, zoti Ministër!

Besoj se do ta trajtoni me të njëjtën përgjegjshmëri edhe çështjen e buxhetit të institucioneve të pavarura, sepse ka ende gjëra që duhen riparë për t'i mbështetur në buxhetin e vitit 2015.

Punë të mbarë! Vazhdojmë dëgjimin e përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme.

Janë të pranishëm zotërinjtë: Genti Kosumi, sekretar i Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Luan Abazi, drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Prokurorinë e Përgjithshme.

Përsëndetje!

E kemi marrë materialin që keni sjellë. Do të dëshiroja shumë shkurt të jepnit pikat kryesore, pa komente, pavarësisht se personalisht, do të dëshiroja të kishte një analizë më të argumentuar të shkaqeve, se përse kërkohet shtesa e madhe në numrin e punonjësve dhe në shpenzimet përkatëse. Gjithsesi, materiali është i njohur dhe u është shpërndarë kolegëve deputetë. Edhe Ministria e Financave, gjithashtu, e ka të njohur, por është e nevojshme të bëni një përmbledhje të shkurtër të pretendimeve tuaja.

Kush e do fjalën?

Genti Kosumi - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Duke shqyrtuar shifrat e projekt-buxhetit të vitit 2015, Prokuroria e Përgjithshme shprehet dakord në parim me projekt-buxhetin e paraqitur për diskutim dhe miratim, por është e nevojshme të trajtojmë disa problematika, të cilat janë shqetësim për Prokurorinë e Përgjithshme, lidhur me numrin e punonjësve dhe me shpenzimet operative.

Në materialin që ju kemi referuar, për sa i përket kërkesës sonë për shtim të numrit të prokurorëve, kemi paraqitur një grafik në të cilin pasqyrohet, duke filluar nga vitit 2002 e deri në vitin 2013 një raport midis rasteve, çështjeve në hetim dhe numrit të prokurorëve. Siç e shihni, numri i prokurorëve ka mbetur i pandryshuar që nga vitit 2002 (është 330), ndërsa, rasti i çështjeve në hetim, ka një rritje prej 300%, siç shihet edhe nga grafiku.

Edhe progres-raporti i vitit 2014 lidhur me eficiencën e gjyqësorit, nënvizon se burimet në dispozicion duhet të rishikohen dhe të shtohen, që të përballohet rritja e ngarkesës së punës në prokurori dhe në gjykata, që të mos ketë anomali në punë nga mungesa e prokurorëve. Një gjë e tillë është parashikuar edhe te udhëzimi Nr. 330, datë 28.05.2014 “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga KE-ja”.

Po të shikojmë prioritetin nr. 4 dhe konkretisht, është pika 2.1/4, thuhet: “Shtimi i prokurorëve në Prokurorinë për Krimet e Rënda dhe trajnimi i tyre në fushat specifike, si dhe në pikat e mëposhtme: “Rishikimi i strukturës në Prokurorinë për Krimet e Rënda lidhur me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, për të parë mundësinë e krijimit të strukturave të specializuara, sipas drejtimeve specifike. Njëkohësisht, po te prioriteti nr. 4 te aktiviteti nr. 6: “Rritja e efektivitetit në strukturën kundër krimit kompjuterik”, sugjerohet ngritja e një strukture të specializuar pranë prokurorisë për ndjekjen e krimeve kompjuterike.

Kjo ishte për sa i përket shtimit të numrit të prokurorëve, ndërsa, për pjesën e stafit mbështetës, rritja që kemi kërkuar konsiston peshën më të madhe specifike kërkesa që kemi bërë ne për specialistë të IT-së. Kjo është bërë duke iu referuar sistemit të menaxhimit të rasteve, që është një sistem i ri, i cili do të fillojë implementimin në janar të vitit 2015. Këtu kemi kërkuar që të kemi nga një specialist IT-je për çdo prokurori. Aktualisht, kemi vetëm 6 specialistë IT-je në Prokurorinë e Përgjithshme.

Pjesa tjetër e stafit që kërkojmë janë mbështetës, ku bien në sy sekretarët pranë prokurorëve, të cilët janë të domosdoshëm. Aktualisht, raportin e stafit mbështetës me prokurorët e kemi afërsisht 1 me 3. Domethënë, për 3 prokurorë kemi një sekretar. Nëse do të miratohet rritja e numrit të prokurorëve, kjo detyrimisht duhet të shoqërohet edhe me staf mbështetës.

Ajo që duam të theksojmë është edhe kërkesa jonë për një rritje në shpenzimet operative. Po të shihni tabelat, shpenzimet operative për vitin 2015 janë pothuajse në të njëjtin nivel me 2014-n. Nga vitet e mëparshme kemi disa borxhe, që kryesisht lidhen me aktet e

ekspertimit në fushën e mjekësisë ligjore dhe të mbrojtjes kundër zjarrit. Herë pas here kemi bërë kërkesa në Ministrinë e Financave, në Ministrinë e Brendshme apo në Ministrinë e Drejtësisë për të ndryshuar aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, në mënyrë që këto shërbime të kryhen pa pagesë midis institucioneve buxhetore. Meqenëse deri tani ky problem nuk ka marrë zgjidhje, për vitin 2015 mendojmë të kërkojmë fonde për likuidimin e tyre. Borxhi që prokuroria ka ndaj këtyre institucioneve deri në momentin që raportojmë është 87 mijë lekë, por deri në fund të vitit mendohet të arrijë në nivelin e 90 mijë lekëve.

Kërkesa jonë për shtimin e zërit të shpenzimeve operative është për likuidimin e këtyre detyrimeve. Një pjesë tjetër e parashikojmë për mirëmbajtjen në eficiencë të plotë të sistemit të prokurorisë, si dhe të aplikacioneve të konfiguruar në këtë sistem. Kërkesa jonë mbështet edhe në udhëzimin e Ministrisë së Inovacionit dhe të Administratës Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”, si dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.

Për sa u përket shpenzimeve për mirëmbajtjen, ato llogariten na masën 12% për vitin e parë, pra për vitin 2015, mbi vlerën totale të investimit; 15% për vitin e dytë, për 2016-n, dhe 18% për vitin e tretë, për 2017-n.

Pak a shumë këto ishin në mënyrë të përmbledhur kërkesat tona.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A kanë kolegët ndonjë gjë për të shtuar?

Zoti Manja, fjala është për ju.

Ulsi Manja – Unë e kuptoj që prokuroria ka nevoja, por dua një argumentim më të qartë në lidhje me numrin e prokurorëve që kërkon të shtohen.

Sa është numri i prokurorëve që ka sot sistemi? Nëse është e mundur, si janë të shpërndarë në të tria nivelet? E kam fjalën për prokuroritë e Shkallës së Parë, për prokuroritë e Apelit dhe ato që ushtrojnë funksionet pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Pyetja tjetër lidhet me ngarkesën e punës. Në raport me numrin e çështjeve, këtu kam parasysh vitin 2013 dhe këtë që jemi, cila është ngarkesa efektive që ka sot një prokuror, i cili merret me hetime aktive? Më lejoni të shpjegojem, këtu e kam fjalën për prokurorët e Shkallës

së Parë, sepse hetimi zhvillohet në prokuroritë e rrethit, jo në prokuroritë e Apelit apo me gjerë. Pra, cila është ngarkesa e punës që përballon në një vit një prokuror?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni!

Genti Kosumi – Numri i prokurorëve sot është 336.

Për sa i përket ngarkesës, nëse do të marrim prokuroritë e Shkallës së Parë, aty ku realisht kryhen hetimet, mund t’ju them që një prokuror sot ka rreth 300 çështje në ditë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Manja nuk ju pyeti për këtë, sepse ndryshe i bie që ai të mos dijë aritmetikë. Edhe ne mund ta marrim shifrën ta pjesëtojmë me numrin e prokurorëve dhe na del numri i çështjeve! Ai ju pyeti nëse ka një studim të ngarkesës sipas prokurorive. Sa është numri i çështjeve jo në raport me çështjet e ardhura, as me ato të filluara, por me ato të përfunduara? Cilat janë llojet e çështjeve, sepse ka çështje që mund të zhvillohen një herë në vit, por ka edhe nga ato që bëjnë hetime çdo ditë? Në fund, sa është numri i çështjeve që gjykon një gjyqtar në Shqipëri dhe sa është në rajon e në Europë?

Genti Kosumi – Numri i prokurorëve vazhdon të mbetet i palëvizshëm, ndërsa numri i çështjeve, të cilat prokuroria i heton dhe i çon për gjykim është trefishuar. Kjo do të thotë se çdo prokurori i bie trefishi i punës në krahasim me vitin 2002. Ka prokurori, si kjo e Tiranës, që kanë një volum shumë të madh pune. Për më tepër, tendenca e punës së prokurorisë po shkon drejt rritjes, në një kohë që numri i prokurorëve është i njëjtë dhe ambientet në të cilat punojnë këta prokurorë janë tepër të vështira.

Ulsi Manja – Unë sigurisht që jam koshient se prokuroria ka nevojë të mbështetet, qoftë edhe me buxhetimin e akteve të ekspertimit, sepse, siç e thatë edhe ju, ky ka qenë një problem dhe vazhdon të jetë ende i pazgjidhur, që institucionet shtetërore vazhdojnë t’ju kërkojnë pagesa për aktet e ekspertimit që bëjnë. Jam shumë koshient që prokuroria ka nevojë edhe për shtimin e personelit ndihmës, siç e thatë, por unë kërkoj që ju t’i bindi edhe kolegët e Komisionit të Ligjeve në lidhje me shtimin e numrit të prokurorëve dhe të oficerëve.

Kam një statistikë, të cilën edhe ju e keni sjellë këtu, ku për vitin 2013 keni raportuar 27 mijë e 651 çështje. Unë nuk po ju them që të 336 prokurorët merren me hetime aktive, sepse janë ndarë në tri nivele, prandaj nuk mora as përgjigje për numrin e prokurorëve që ushtrojnë

funksion në Shkallën e Parë. Në rast se do të më jepni numrin e prokurorëve që ushtrojnë funksion në Shkallë të Parë, që më pas ta pjesëtojmë me numrin e çështjeve, në atë matematikën që di unë, mesatarisht shkon 120 dosje një prokuror, jo 300. Ju këtë shifër keni dhënë, 27 mijë e 677, të cilën po ta pjesëtojmë me 330, shkon diku te 83 çështje ngarkesa për një prokuror. Por duke marrë në konsideratë që në Shkallë të Parë mund të jetë një numër relativisht 190-200 prokurorë, nuk e kam shifrën e saktë, të cilën ua kërkoja, po të pjesëtohet me numrin e çështjeve shkon rreth 120, ose po të doni ju edhe 150 dosje në vit, që duke e pjesëtuar me 12 muaj shkon një ngarkesë mesatarisht 10-15 dosje një muaj për një prokuror.

Pra, e bëra këtë koment, sepse në rast se është i domosdoshëm shtimi i prokurorëve, ky komision, por edhe unë që vij nga radhët e prokurorisë (këtu kërkoj mirëkuptimin e kolegëve të Komisionit të Ligjeve) do të ndërmerre një iniciativë në këtë drejtim, ku t'i kërkohet Ministrisë së Financave dhe qeverisë shtimi i buxhetimit për rritjen e numrit të prokurorëve, por edhe për pjesën e administratës ndihmëse, nëse janë dakord, qoftë për sekretarët, qoftë për punonjës IT-je, sepse sot, në 2014-n, kemi 6 punonjës IT-je, por qenkan te Prokuroria e Përgjithshme. Ndërkohë që shumë institucione të këtij shteti po shkojnë drejt dixhitalizimit, prokuroria shqiptare, si një institucion shumë i rëndësishëm në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, vazhdon të mbetet nëpër rrethe pa punonjës IT-je. Për këtë pjesë, të jeni të bindur, keni të gjithë mirëkuptimin e komisionit dhe do të insistojmë në këtë drejtim. Nuk po hyj te oficerët e Policisë Gjyqësore, që kanë barrën e hetimit. Ndërsa për prokurorët insistoj, sepse nuk më rezulton kjo lloj ngarkese që ju thoni.

Ajo që mund të ketë nevojë prokuroria është një rishpërndarje siç duhet, ose duhet riparë rishpërndarja e numrit të prokurorëve në prokuroritë e Shkallës së Parë. Nuk mundet që në një prokurori që lëviz 500 procedime në vit të lihen 8 prokurorë, ndërsa në prokurorinë e Tiranës, ose te Krimet e Rënda ka një numër të limituar prokurorësh. Pra, nëse janë këto shifra që ju keni sjellë, ndoshta jam i gabuar unë në atë matematikën time, mua më rezulton e kundërta e asaj që ju thoni. Po të na jepni edhe numri i prokurorëve që janë realisht në Shkallë të Parë, ndoshta mund të dalë, por qofsha unë i gabuar!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi, fjala është për ju.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme!

Duke u bashkuar me shqetësimin e kolegut, unë kam një pyetje për rastet e mosfillimit të procedimeve dhe të pezullimeve të tyre, njëkohësisht edhe për respektimin e afateve të hetimit. E them këtë, sepse, sipas informacionit që keni dorëzuar këtu, ju thoni se numri i procedimeve të regjistruara është rritur, por sipas po raportimit që ka bërë prokurori i Përgjithshëm, të paktën çdo vit në parlament, rezulton që vetëm 30% e çështjeve shkojnë në gjykatë. 33-35% çdo vit vendoset mosfillim. Keni pushime, keni pezullime: pra rreth 70% e çështjeve nuk ka fatin të shkojë në gjykatë. Koha që konsumon një prokuror, kur diskuton - sheh nëse do të fillojë apo procedimin - nuk është e njëjtë me kohën që merret hetimi i plotë, paraprak, derisa çështja të paraqitet në gjykatë.

A keni ndonjë studim lidhur me këto elemente, lidhur me respektimin e afateve të hetimit? Mendoj që shumë gjëra lidhen edhe me menaxhimin e punës së prokurorëve dhe me faktin që prokurorët nuk mund të vazhdojnë të jenë më ata që supervizojnë hetimin, ndaj të merren vetëm oficerët e Policisë Gjyqësore. Unë jam dakord me shqetësimin që ngrini ju, që ka nevojë të rritet numri i prokurorëve. Po nuk them dot se sa duhet rritur, nëse duhet miratuar i gjithë numri që kërkohet. Jam dakord që keni nevojë që të rritet numri i personave të IT-së, sepse është normale që duhet të keni persona për të ruajtur, për të bërë dhe transparencën e institucionit, por edhe për format e reja të kriminalitetit. Unë do ta doja që në këtë raport të thoshit konkretisht që a u përgjigjen kërkesat tuaja atyre prioritetëve që kemi: task-forcave për luftën kundër korrupsionit, krimit kibernetik, krimet në fushën e mjedisit?

Do t'i lutesha dhe relatorit, që po bën një punë të jashtëzakonshme në detajimin e këtij buxheti, që të shihet mundësia e një numri prokurorësh. Do të doja gjithashtu, zoti kryetar i Komisionit, që shumë shpejt t'i kërkojmë Prokurorisë së Përgjithshme që të thirret në raport me një studim lidhur me afatet e respektimit të të drejtave të qytetarëve për afatet e hetimeve, me analizë për shkaqet e mosfillimit të rasteve të procedimeve penale, të shikojmë nëse ka ankime për cilësitë e denoncimeve të materialeve. Si Komision që mbulojmë një sërë institucionesh që lidhen me punën e prokurorisë, të vëmë në vijë funksionimin e tyre.

E fundit. Në varësi edhe të përgjigjeve që do të marr nga pyetjet e mia, duhet ta shikojmë edhe një herë atë rishpërndarjen e numrit dhe të ngarkesës së punës së prokurorëve. E

them këtë, sepse në Progresraportin 2014, ku kërkohet shtimi i burimeve, thuhet të rishikohet edhe një rishikim dhe një rishpërndarje e tyre. Nga ne kërkohet të bëhet një punë, por edhe nga ana e prokurorisë kërkohet të bëjë detyrat e saj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka ndonjë reagim nga prokuroria, para se të reagojë Ministria e Financave?

Genti Kosumi – Numrin që kërkoi zoni Manja, mund ta japim, se e kemi të detajuar këtu. Bëmë një mbledhje me prokurorë të nivelit të parë, të shkallëve të para: gjithsej janë 277.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ministria e Financave. Zonja sekretare e Përgjithshme.

Gelardina Prodani – Në fakt, qeveria e ka vlerësuar pavarësinë e institucionit të prokurorisë, duke vlerësuar shumë edhe luftën kundër korrupsionit. Buxheti për Prokurorinë e Përgjithshme është 1,7 miliardë. Është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2014, por është një nga buxhetet historike që ka marrë ky institucion, duke krahasuar që nga viti 2005 e deri më sot. Për sa i takon ngarkesës dhe kërkesës që ka bërë Prokuroria e Përgjithshme për punonjës shtesë dhe për prokurorë të përgjithshëm, Ministria e Financave dhe qeveria mund të shprehet vetëm për punonjësit mbështetës, por jo për prokurorët e përgjithshëm. Kemi shtuar një staf prej 13 vetash, dhe numri i punonjësve të Prokurorisë ka shkuar në 388 nga 325 që ka qenë një vit më parë. Ky numër shtesë është shoqëruar edhe me shtesë të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe në fondin e shpenzimeve për fondin e pagave.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka ndonjë reagim për... Nuk po kuptoj dot...

Gelardina Prodani – Ministria e Financave gjykon që i ka plotësuar një pjesë të kërkesave që ka Prokuroria.

Fatmir Xhafaj – Po ju për të plotësuar kërkesat jeni.

Gelardina Prodani – Kërkesat jo gjithmonë janë financuar.

Fatmir Xhafaj – Nëse kërkohen të ngrenë një sektor të krimit kibernetik, u duhet një zyrë e veçantë, dhe më duket se është e arsyeshme. Nëse kanë nevojë për specialistë të teknologjisë së informacionit, mund ta na e detajojnë se ku i duan, që të kuptojmë logjikën. Nëse kërkohet një specialist i tillë në një qytet ku ka vetëm një prokuror, nuk më bën sens. Nëse na

detajohet, mund të reflektojmë. Nëse kërkon një fond në lidhje me vazhdimin e programit IPA, është logjike. Është një bazë e tërë të dhënash. Nëse ka 90 mijë lekë për të paguar, si do t'ia bëjë? Apo do t'i mbyllni derën, si ujësjellësve për CEZ-in? Nuk bën sens. Duhet ta zgjidhni: janë çështje brenda për brenda. Po pagesa që ka bërë për ekspertizë?

(Diskutim pa mikrofon.)

Gelardina Prodani – Ajo mund të trajtohet edhe me detyrimet e prapambetura.

Fatmir Xhafaj – Atëherë i shikojmë me prioritet këto që lidhen me mirëmbajtjen e sistemit të IT-së. Nëse na sjellin një gjë më të qartë edhe për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore, ku të kuptojmë ngarkesën, duhet ta diskutojmë.

Biem dakord, zoti Fino? Po.

Ju të Ministrisë?

Gelardina Prodani – Unë kam një ndërhyrje. Niveli i investimeve është 250 milionë lekë: në lidhje me infrastrukturën, për IT-në etj. Është prokuroria që vendos prioritetet për investimet brenda tavanit që ka.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Por nuk bëhet fjalë për investime, por për shpenzime operative dhe shtesë në numrin e punonjësve. Këto nuk i menaxhon brenda kufirit që u keni dhënë ju.

Zonja ministre.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Prezenca ime sot lidhet me njërën prej përgjegjësive të ministrit të Shtetit për Parlamentin, që të ndjekë në vijimësi shqetësimet e institucioneve të pavarura. Jam njohur me kërkesat e Prokurorisë së Përgjithshme për rritjen e kapaciteteve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Për këtë, ministri është përfshirë që më parë në një komunikim me Ministrinë e Financave: për ta adresuar këtë problematikë. Mund t'ju them që nevojitet që të kemi një vëmendje të veçantë në këtë pikë, sepse thjesht nga grafiku, por edhe nga shifrat vumë re një gjë shumë të thjeshtë. Në më shumë se një dekadë, ne vijojmë të kemi të njëjtin numër prokurorësh, ndërkohë që jemi koshtues se krimi është rritur. Shumëkush prej nesh mosfillimet i konsideron sikur nuk ka punë, por edhe ato kanë punën e vet brenda, që nuk figuron tek ajo shifra. Shifra është edhe disa herë më e lartë.

Kemi, nga viti 2002 e sot në vitin 2014, një trefishim të procedimeve penale. Aty janë të përfshirë të gjithë prokurorët, sepse çështja kalon shkallët dhe natyrisht do të përfshihet edhe prokurori i shkallës së parë, edhe ai i shkallës së dytë, edhe ai që vepron pranë Gjykatës së Lartë. Vetëm duke parë këtë duhet të mendojmë, nëse nuk e konsiderojmë këtë kërkesë, kemi lejuar që të cedohet me cilësinë e hetimit. Nuk mund t'i kërkojmë prokurorisë apo gjykatës që të bëjnë një luftë, duke mos pasur kapacitete njerëzore. Nuk është ajo shtesa e 13 punonjësve që e bën hetimin. Hetimin e bëjnë prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore.

Është dhe një kërkesë e BE-së, do të desha që të vënë më mirë në vëmendje: që i duhet vënë kujdes kësaj pjese. Për këtë arsye, do të insistoja që Ministria e Financave ta rishihte edhe një herë këtë gjë. Dhe të mund ta menaxhonte këtë pjesë.

Edhe për pjesën e menaxhimit të rasteve...

Fatmir Xhafaj – Zonja Felaj, besoj e dini se nuk jeni më anëtare e Komisionit të Ligjeve.

Ermonela Felaj – Jam ministre e Shtetit për Parlamentin dhe kërkoj të nxis vëmendjen tuaj në këtë pikë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Tashti besoj se është çështje e deputetëve të Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit, edhe për vëmendje që na e zgjuat!

Edhe ministrja mbështeti shqetësimin e kolegëve të mi deputetë të Komisionit, por do të kërkoja nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme të detajojnë me shpejtësi. Ne do të jemi këtu edhe nesër. Jemi në kohë për të reflektuar. Veçse duhet të keni më shumë argumente bindëse që edhe ne, së bashku ministren Felaj, të bindim Ministrinë e Financave.

Genti Kosumi – Për sa u përket raporteve që kërkoj zonja Hysi, ato ekzistojnë të gjitha. Ka edhe drejtori studimesh që i kanë këto raporte të plota. Si unë, si drejtori i financës, nuk bëjmë pjesë te stafi i prokurorëve, por jemi staf administrativ. Nuk e pamë të arsyeshme që t'i merrnim, por mund t'ua vëmë në dispozicion çdo moment.

Për sa i përket detajimit të specialistëve të IT-së, janë plotësisht të detajuara. Siç e kemi paraqitur te kërkesa, drejtorja e IT-së aktualisht funksionon vetëm në Prokurorinë e Përgjithshme, me 6 specialistë, të cilët mbulojnë gjithë sistemin, në të gjithë Republikën e

Shqipërisë, kudo ku ka prokurori, të shkallës së parë apo të apelit. Kërkesa jonë është e detajuar të kërkojmë nga një specialist IT-je për...

Fatmir Xhafaj – Nuk dua të të ndërpres, por shikoje edhe një herë. Nuk më bën sens që, ku ka një prokurori apeli, të jetë edhe një IT. Ne që jemi në këtë tavolinë, e njohim këtë fushë. Uluni me ata të gjykatës dhe shikojeni që nuk e kanë këtë luks që po kërkonin ju. Padyshim, ju mund të keni bazë më të... Por edhe ata kanë një sistem të tërë të integruar: menaxhimin e çështjeve civile dhe penale. Bëjuni më realistë, që të kemi mbështetje më reale. Besoj që do të keni mbështetje, por të keni një kërkesë realiste. U kuptuam, besoj, se çfarë po them?...

Vazhdojmë me Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Kjo zyrë përfaqësohet nga zoti Sandër Simoni, anëtar i Bordit Drejtues të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, që mban njëkohësisht edhe detyrën e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe nga zonja Luljeta Laze, drejtoreshë e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, e njohur për të gjithë këtu, sepse është bërë si e shtëpisë, sa herë që ka buxhet.

Përpara kemi të gjithë materialin, ku kemi vënë shënimet respektive. A keni ndonjë koment të shkurtër?

Po, zonja Laze.

Luljeta Laze – Unë po i prek shumë shkurt elementet kryesore.

Sigurisht që kemi një rritje të buxhetit për këtë vit, rreth 4%. Ajo që na ka kënaqur më shumë është fakti i strukturës së kësaj rritjeje, sepse vjet kemi pasur një rritje më të madhe 19%, por buxheti i investimeve nuk ishte kaq i rritur. Pjesa më e madhe e rritjes ishte për shkak të rritjes së numrit që kemi përfituar vjet. Sivjet struktura e rritjes është 1% për shpenzimet korrente dhe 50% për investimet.

Një tjetër gjë që do të përmendja është se kemi një rritje të numrit të punonjësve me 30 veta, gjithmonë bëhet fjalë për administratën gjyqësore. Sigurisht që kërkesa jonë është më e madhe, por me ato pak argumente që jemi munduar të sjellim këtu, e kuptojmë faktin që rritja e numrit të menjëhershëm sigurisht që është e vështirë, por duhet të mbahet vazhdimisht në vëmendje, sepse kërkohet një rritje e moderuar vit për vit. Duke iu referuar nevojës që paraqitet vazhdimisht te ne nga raportet që bëhen dhe nga kërkesat që paraqesin kryetarët e gjykatave, por

duke iu referuar edhe disa raporteve të tjera të Komisionit European për eficiencën, unë i kam përmendur aty, sot në Shqipëri raporti i gjyqtarëve me administratën gjyqësore është dy me një. Domethënë, dy punonjës administrate për një gjyqtar, ndërkohë që në vende të tjera mesatarja është tre me një. Edhe te vendet e Ballkanit është lart, ndoshta kjo për faktin se këto vende, që duan të aderojnë nesër në BE, duhet të mbështeten me buxhet. Gjithsesi, ne jemi të kënaqur me rritjen me 30 punonjës, sepse mbulon një pjesë të nevojave.

Një gjë tjetër e rëndësishme është se kjo rritje e numrit të punonjësve është mbështetur edhe me buxhetin përkatës. Kaq ishte për sa i përket pjesës së shpenzimeve për personelin dhe për numrin e punonjësve.

Për sa u përket shpenzimeve operative, sigurisht që jemi të pakënaqur për shkak se buxheti është në të njëjtin nivel me atë të miratuar me ligj për vitin 2014. Ndërkohë, buxheti efektiv i shpenzuar është shumë më i lartë. Sigurisht që gjatë kësaj kohë ka pasur një mbështetje nëpërmjet buxheteve shtesë për të gjitha detyrimet që kemi pasur nga strategjia që është përdorur nga Ministria e Financave. Gjithashtu, dua të përmend se kemi përdorur shumë buxhet në kuadër të shpenzimeve korrente nga mungesa e numrit të punonjësve, kryesisht gjyqtarë, por edhe të tjera, për arsye të ndryshme dhe i kemi mbuluar të gjitha nevojat që kemi pasur me shpenzime operative. Kam bërë një llogari të thjeshtë, që besoj se është e qartë aty, rritja e numrit të çështjeve është 5%. Ajo është që vërejtur specifikisht sivjet nga funksioni i gjykatave administrative është fakti se edhe numri i çështjeve administrative në tërësi është rritur shumë. Ndikimi i inflacionit për çdo vit është 3% dhe ne kemi përlogaritur edhe sesa është ky efekt në këtë buxhet, sepse nuk është kaq. Kërkesa jonë për 30 milionë lekë shtesë në shpenzimet operative mbetet. Nuk e di së çfarë mund të na thotë Ministria e Financave.

Për sa u përket investimeve, ajo që kam përmendur është rritja vërtet e konsiderueshme. Ndoshta është hera e parë që po i kushtohet vëmendja e duhur. Planetet tona strategjike për zhvillimin e infrastrukturës, kryesisht ndërtimore të gjykatave, janë të qarta prej disa vitesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

50% nga buxheti që ishte. Ne nuk po themi ndonjë gjë të madhe, përveç faktit që kemi përsëri nevoja të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më duket se e përmenda edhe këtë gjë, po tani nevoja jonë është edhe më e madhe. Këtë e mbështes edhe më faktin që kemi projekte të gatshme. Kështu, jemi në të drejtën tonë për të thënë: “Po, ne kemi mundësi për t’i përdorur edhe ato.” Kemi pasur kontakte si me Drejtorinë e Projekteve në Ministrinë e Drejtësisë, ashtu edhe me Departamentin e Strategjive në Kryeministri dhe ato na kanë informuar se fondet e IPA-s do të jenë të bashkuara dhe menaxhimi i tyre në mënyrë të përqendruar ndoshta na ndihmon që një pjesë e projekteve të financohen edhe nga projekti i IPA-s. Strategjia do të përfundon në muajin dhjetor 2014, mesa jemi të informuar, kështu që në njëfarë mënyre presim edhe përfitim të prej tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tek investimet nëse është mundësia. Duke qenë se do të fillojmë projektin, si Elbasani dhe ka dalë si prioritet Gjykata Administrative...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, do ta fillojmë sivjet, sepse projekti është bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi projekte të gatshme, por nuk mendojmë t’i fillojmë tani.

Bashkim Fino – Zyra e Administrimit të Pushtetit Gjyqësor është dakord me numrin e punonjësve dhe është e kënaqur me shtesën prej 30 punonjësish, e kënaqur, në njëfarë mënyrë, me investimet si asnjëherë tjetër. Të vetmen vërejtje që bëri, të cilën unë po e shikoj me vëmendje, është çështja e shpenzimeve operative. Si ekonomist them se keni një të drejtë, sepse, në momentin kur ne ju miratojmë rritjen me 30 veta, ju miratojmë pagën dhe sigurimet shoqërore, ndërkohë këta 30 veta do të punojnë dhe do të kryejnë edhe disa shpenzime operative. Propozimi im është: në qoftë se këta kërkojnë 30 milionë, Ministria e Financave t’u japë gjysmën të paktën, 10-15 milionë, që këta 30, që hyjnë të rinj, të keni mundësinë e shpenzimeve për të punuar. Besoj se mbyllim këtë zyrë me këtë dhe le t’i japim fjalën financës të thotë ndonjë gjë, pa dashur të themi se ku do t’i bëjnë apo nuk do t’i bëjnë investimet. Rëndësi ka që janë të kënaqur me investimet dhe me numrin, por janë të pakënaqur vetëm me shpenzimet.

Zoti kryetar, për shpenzimet unë them të bëjmë një shtesë prej 10-15 milionësh dhe e mbyllim këtë gjë.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Luljeta Laze – Është e përfshirë pjesërisht.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Zoti Simoni, a jeni dakord me këto që ramë dakord?

Sandër Simoni – Sigurisht që jemi dakord.

Dua të them diçka lidhur me atë që tha zoti Fino. Ne si bord jemi të kënaqur me shtesën në personel që kemi kërkuar dhe e kemi shprehur mendimin tonë. Kërkesat kanë qenë racionale dhe të argumentuara. Janë kërkuar 54, duke u bazuar në modelet minimale të një strukture bazike për strukturat gjyqësore. Kemi parasysh që, në fakt, strukturat gjyqësore kanë pozicione dhe kategori page që nuk përbëjnë shumë shpenzime në buxhetin e shtetit, sepse ato janë kategori pagash IVC, IVB, shumë-shumë IVA dhe janë të ulëta. Kështu kërkesat tona për shtim punonjësish nuk ka ndonjë impakt të jashtëzakonshëm. Edhe po të ishin shtuar 54, kam përshtypjen se nuk do të ishte ndonjë gjë e madhe, por do të kishim ndikuar në eficiencën dhe në llogaridhënien për vitin tjetër.

Për shpenzimet buxhetore u qëndrojmë atyre që u diskutuan këtu. Edhe një herë, në emër të bordit, shpreh kënaqësinë që janë marrë parasysh kërkesat dhe ka një rritje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Dëshiroj t'ju bëj me dije dy gjëra. Ndërhyrjen që bëra për prokurorinë do ta bëj edhe për ju. Në kuadër të reformës në drejtësi, një nga komponentët kryesorë të saj, që besoj se do të publikohet gjatë ditëve në vijim, do të jetë edhe çështja e organizimit gjyqësor. Ne do t'u kërkojmë misionëve të asistencës ndërkombëtare në Tiranë, por edhe ekspertizës vendase së bashku me ju të bëjnë një studim të plotë të shpërndarjes, të ngarkesës, të nevojës që ka për gjyqtarë, për prokurorë dhe për staf mbështetës, sepse, siç mund të jetë pretendimi që të ketë më shumë staf mbështetës, unë jam partizan dhe jam absolutisht dakord me këtë pretendim, ashtu mund të ketë nevojë që të ristrukturohen edhe gjykatat, edhe prokuroritë, se nuk është çudi që mund të ketë nevojë për shkurtime, sepse, po të marrim numrin e çështjeve që gjykon sot një gjyqtar në Republikën e Shqipërisë, është disa herë më i ulët se një gjyqtar në Republikën e Gjermanisë.

Hapeni, meqenëse e përmendi atë SEPEZH-in shumë, se keni një studim. Më i fundit është bërë para dy vjetësh. *(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, por nuk ka ndryshuar edhe ngarkesa, edhe impenjimi. Megjithatë, ky është një diskutim tjetër. E rëndësishme është që sivjet kemi 50% të buxhetit rritje për investime. Do të ketë një rritje shumë të madhe lidhur me investimin që do të bëhet për godinën e Gjykatës së Lartë, në mënyrë që në godinën e drejtësisë të përfshihen të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit që janë në Tiranë, gjë që krijon shumë frymëmarrje nga pikëpamja e ambienteve. Ju keni shumë të drejtë, prandaj ju mbështetëm fort, lidhur me shpenzimet operative.

Faleminderit! Ditë të mbarë!

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka dërguar *email*. Është dakord dhe është shumë i lumtur që i ka rilindur buxheti.

Fatmir Xhafaj – Kam një pyetje. Çfarë i bëhet financës në qoftë se Gjykatës Kushtetuese, të paktën, i jepen 10 milion lekë të reja? Të paktën 10 milionë. (*Mungesë incizimi*)

Kanë problem makinat, i kanë të degraduara totalisht. Nuk i keni dhënë për 2015 –ën. Dalin t'i prokurojnë, nuk arrijnë t'i prokurojnë, kështu që i bie 7 milionë, plus këtë ndryshim që keni, të fondit të pagave të sigurimeve shoqërore, atë e bëni lehtë ju, s'ka asnjë problem. Ka 1 milion për bibliotekën. Është Gjykatë Kushtetuese, këta nuk kanë punë me rrugë e me çakuj, këta kanë punë me libra. Për dixhitalizimin kanë 1,5 milionë, për të cilin ne kemi rënë dakord me ju që do t'i mbështesim vit pas viti dhe 0,5 milionë që e kanë për pajisjet për të pasur disa kushte normale. Kanë shumë kërkesa të tjera, por unë po e përmbledh në 10 milionë lekë të rinj, që shkojnë 100 milionë. (*Diskutim pa mikrofon.*)

Kujtim Osmani – Për të qenë racionalë, ne kemi kapur problemet shqetësuese, problemet pikante dhe kemi dhënë në mënyrë tepër koncize, me idenë që ju na keni mirëkuptuar dhe besoj se po e shprehni këtë ndjenjë mirëkuptimi. Gjykata Kushtetuese po e vlerëson këtë përkrahje që po i bëhet me proceset që zhvillon në mënyrë të shpejtë.

Bashkim Fino - Jam dakord. Nëse Ministria e Financave sot i mbajti shënim këto 10 milionë lekë investime, plus operative, i rregullon. Besoj se është një gjë që zgjidhet dhe është e zgjidhshme. (*Diskutim pa mikrofon.*)

Kujtim Osmani -Asnjë koment. Jemi shumë të kënaqur me këtë qëndrim që mbahet. Si asnjë vit tjetër, këtë vit duket më i plotë dhe ju falënderojmë për gjithë përkrahjen që na jepni!

Fatmir Xhafaj –Ju nuk jeni zyra e administrimit të buxhetit gjyqësor që të keni 100% investime.

Kujtim Osmani – Investimi ynë është vendimmarrës, nuk kemi ç’të bëjmë tjetër gjë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Dakord me rritjen që propozuan kolegët dhe që e përforcoi zoti Fino në cilësinë e relatorit dhe që e mbështeti financa për 10 milionë lekë të reja? Faleminderit! Gjithë të mirat!

Vazhdojmë me Shkollën e Magjistraturës. Zonjat e Shkollës së Magjistraturës dhe konkretisht zonja Qokaj, kancelare e Shkollës së Magjistraturës dhe zonja Natasha Cita, shefe e financës.

Ela Qokaj- Ju falënderoj! Pa dyshim që takimi me ju është kthyer në traditë dhe është një nga takimet më të rëndësishme që kryen shkolla për sigurimet financiare të nevojshme.

Buxheti i shtetit për këtë vit për Shkollën e Magjistraturës ka akorduar një fond prej 60 milionë e 500 mijë lekë, një buxhet i cili është negociuar në të gjitha fazat e tij me ministrinë e financave. Shkolla ka fatin e mirë që të mbështetet dhe nga donatorët, nga partnerët ndërkombëtarë dhe megjithëse në vitet e fundit, e shprehur në vlerë monetare ato kanë rënë, më shumë ka ekspertizë.

Unë mendoj se ky buxhet që ka vendosur Ministria e Financave, në tërësinë e tij është i mjaftueshëm. Kjo për shkak të disa ndryshimeve për fondin e ligjit për Shkollën e Magjistraturës, i cili e pezulloi provimin e pranimit këtë vit për vitin e parë akademik dhe shpenzimet që ishin programuar këtë vit, të cilat janë të konsiderueshme për veprimtarinë e shkollës, për atë buxhet që ajo ka, do të kalojnë automatikisht për mbulimin e nevojave që ne kishim për trajnimin vazhdues.

Pra, këtë vit, programi i trajnimit vazhdues mbështetet tërësisht nga buxheti i shtetit për sa i përket sesioneve që janë programuar për të, përveç pjesës së donatorëve, sepse ne operojmë me program 3-vjeçar dhe aty ka dhe sesione trajnuese të mbështetura nga donatorët.

Një nga kërkesat tona ka qenë shtimi i numrit të punonjësve, me një punonjës, e cila është marrë parasysh nga Ministria e Financave dhe është akorduar dhe fondi i pagave për këtë gjë. Për shkak të ndryshimeve ligjore që unë përmenda, ka dhe një teprice në zërin “bursa”, që nuk mund të përdoret për asgjë tjetër, por vetëm për bursa dhe në këtë fazë të buxhetit ne do të donim që ajo të transferohej për investime, sepse shkolla ka shumë nevojë për investime. Në fakt

ambientet janë të vogla, kërkohen shumë investime, por për aq sa kemi, ne do të donim të rinovonim sallën e konferencave, sallën e sesionit trajnues. Janë 2,5 milionë lekë nga bursa.

Fatmir Xhafaj– Atë që keni do ta kaloni nga rialokim brenda për brenda, nuk po kërkoni shtesë.

Ela Qokaj – Po, brenda për brenda, nuk kërkojmë shtesë absolutisht. Është një fond shumë i vogël investimesh. 1 milionë lekë ka qenë disa vite me rrallë.

Fatmir Xhafaj– Ky komision ka bërë një ligj të posaçëm dhe do t'i qëndrojë atij ligji.

Bashkim Fino – Që të jetë korrekte zonja Moza dhe që kuota për bursat nuk mund të kthehen në investime, mund t'i shtojmë investimet. Nga 1 milion mund t'i bëjmë 3 milionë për Shkollën e Magjistraturës dhe këto 2 milionë mund t'i marrë si bursë. Kjo është një zgjidhje më e arsyeshme për të mos pasur probleme.

Natasha Cita - Në fakt ne diskutuam për nevojat që ka Shkolla e Magjistraturës, duke mirëkuptuar për shtesën e punonjësit të IT-së, meqenëse trajnimet vazhduese tani do të kenë prioritet në krahasim me shkollimin dhe e vumë me kushtin që të zbrisnim pjesën e bursave. Ky ka qenë një gabim teknik yni, nuk e kemi zbritur, ndaj këto 2 milionë ne duam të kthehen.

Fatmir Xhafaj– Ju nuk e dini se çfarë mund të bëjmë ne deri në fund të vitit, sepse mund të marrim ndonjë shtesë në ligjin që është dhe mund t'ju kthejmë jo vetëm aq, por edhe më shumë. Shkolla e ka të domosdoshme sallën e konferencave, sistemin e fonisë, sepse bëhen trajnime me gjyqtarë, me prokurorë, me lektorë të huaj. Nuk është serioze që ajo sallë mos të jetë në gjendje shumë të mirë. Nuk është serioze për funksionalitetin, por dhe për seriozitetin dhe imazhin e shtetit.

Bashkim Fino – Duhet të pranojmë që shkolla e magjistraturës nuk kërkoi asgjë te mallrat dhe shërbimet. Ka një ulje nga 2014 në 2015, nga 19 milionë në 17 milionë. Domethënë, ata janë dakord me këtë shifër. Mund t'i japim këtë shifër, deri në 3 milionë. 1 milionë e kanë dhe do të thotë që do të shtojmë 2 milionë, pa llogaritur pjesën e bursës dhe punonjësia e IT-së, dhe e mbyllim. Është më se korrekte dhe kjo. Të gjithë këtu kërkuan mallra dhe shërbime më shumë, kërkuan më shumë lekë, këta nuk kërkuan në këtë drejtim. Atëherë mund t'i japim.

Fatmir Xhafaj – KLD-ja është e lumtur nga ajo që ka marrë, madje besojmë se do të jenë akoma më të lumtur në ditët që vijnë. Nesër në orën 10:00 do të kemi miratimin e ligjit, më pas ministren për Inovacionet dhe Administratën Publike, më pas ILDKP-ja, KQZ-ja, Avokati i

Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Instituti i Studimit dhe Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil.

Nesër, ju lutem, kolegëve deputetë sipas rendit të ditëve dhe Ministria e Financave gjithashtu, prezentë!

Punë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET